

D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Shkurt 2010 • Viti XXVII • Nr. 2 (184) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA \$2.50



KRESHMËT - Kohë urate, flijimi dhe bamirësie!

FAQE 8-9

Shkruan:
Don Robert JAKAJ



Figura biblike: Zoja e Bekuar – Virgjëra Mari

FAQE 16

Shkruan:
M. OLLGA DULAJ



Ndihma (udhëzime) shpirtërore për të kuptuar dhe jetuar kreshmët

FAQE 18

Shkruan:
DON NIKSON SHABANI



Kryqi – shprehje dashurie dhe faljeje

■ SHKRUAN:
Don Lush GJERGJI

Njeriu dhe njerëzimi gjithmonë ka qenë i kërcënuar nga frikësimet e ndryshme, prej katastrofave natyrore, sëmundjeve të pashërueshme, krizave dhe luftërave, e tash deri te armatimi dhe rreziku i luftës bërthamore, asgjësimi...

Përpos këtyre “frikësimeve” të mëdha dhe gjithënjëzore, çdo njeri ka ndonjë frikë, shqetësim, pasiguri, që e mundon në shpirt dhe e rëndon në zemër.

Frika më e madhe buron nga pësimi, vuajtja, kërcënimet, rrezikimi, dëbimi, anësimi, harresa, përbuzja, mbi të gjitha vdekja, që me një emër të përbashkët të krishterë mund t’i quajmë “KRYQ”.

Fakti tjetër i pamohueshëm është ky: megjithatë çdo njeri vuan doemos në trup dhe në shpirt, herë më shumë e herë më pak, por gati gjithnjë. Dhe në këtë lëmi filozofia, shkenca, mjekësia, kultura, arti... janë “memece” dhe pa ndonjë përgjigje të saktë, të plotë, bindëse, të pranueshme dhe të pëlqyeshme për të gjithë.

Pyetja pse, pse dhe gjithnjë pse, unë duhet të vuaj kaq shumë, kaq gjatë, gati gjithnjë, e çka është edhe më keq, padrejtësisht, më tepër se të tjerët, megjullon mendjen dhe ngurtëson zemrën. Dhe pse-hi zgjerohet, thellohet, zgjatet pa skaj dhe pa ndonjë përgjigje konkrete.

Në Kryq është shëlbimi, na mëson feja e krishterë, sepse Jezu Krishti, Zoti i vërtetë dhe Njeri i vërtetë, i vetmi lirisht, vullnetarisht, me dashuri dhe për dashuri, ka vuajtur, ka vdekur, është varrosur, është ngjallur për çdo njeri, edhe për ata që kanë munduar dhe kryqëzuar. Pse? Për ta “larë borxhin tonë”, për t’u bërë Avokati dhe Mbrojtësi ynë kundruall Djallit, mëkatit dhe vdekjes, për të na bërë të mirë dhe të lirë, për të na siguruar shëlbimin, amshimin.

Vuajtja është si dashuria, ajo nuk mund të kuptohet kurrë deri në fund, por mund të pranohet apo të dëbohet, dhe kryesisht varet prej dhuratës së fesë dhe frymëzimit të dashurisë. Prandaj mund të themi edhe kështu: besojmë aq sa jemi të aftë të vuajmë dhe të dashurojmë.

Sinteza mbi kryqin e Krishtit mund të jetë kjo: “*E, ndërsa hebrenjtë kërkojnë mrekulli, e grekët lypin urti, ne predikojmë Krishtin e kryqëzuar – për hebrenj shkandull e për paganë marri, kurse për të grishurit si hebrenjë si grekë – Krishtin – fuqinë e Hyjit dhe dijen e Hyjit*”/ 1 Kor 1, 22-24/.

Këtë më së miri e ka dëshmuar Jezu Krishti, i cili e zgjodhi rrugën me dy binare, atë të dashurisë dhe të flijimit. Dashuria e vërtetë është gjithmonë dhembje, flijim, dhurim, dhe flijimi pa dashuri rrënon dhe asgjëson çdo gjë.

Nga Kryqi i Krishtit edhe në mund ta mësojmë artin e jetës, që domethënë kryesisht:

Çdo gjë ka kuptim, porosi, domethënie, pra, edhe vuajtja, si pjesë e rëndësishme e jetës, e cila nuk mund të pranohet dhe të bartet pa Jezu Krishtin, pa fe dhe dashuri.

Në kryq dëshmohet, tregohet dhe dhurohet dashuria kulmore e Zotit për njeriun.

Vetëm nëpërmjet kryqit edhe ne jemi pjesëmarrës në veprën e madhe të shëlbimit.

Nuk ia vlen të vuajmë kot, keq dhe të vetmuar, por nëpërmjet vuajtjes së ofruar dhe të dhuruar të jemi bashkëvuajtës me Jezu Krishtin dhe me njëri-tjetrin.

Mu për këtë gjatë kohës së Kreshmëve, sidomos gjatë Udhës së Kryqit, ne gjuhëzohemi para Kryqit dhe themi: *T’adhuojmë o Krisht, e të bekojmë, se me Kryqit tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë!*

Stublla dje dhe sot

FAQE 14-15

Shkruan:
Sarë GJERGJI

Intervistë me Jusuf Buxhovin, shkrimtar dhe publicist

Figurat e ndritshme shqiptare: inspirim për një kulturë të shëndoshë

FAQE 12-13

Letër baritore e Imzot Dodë Gjergji famullive të Kosovës

Të dashur vëllezër meshtarë!
Rregulltarë e rregulltarë!
Motra dhe vëllezër në Krishtin!

"Hiri i Jezusit, Zotit tonë, qoftë me ju!" (Rom 16, 20b)

Pas tre viteve të shërbimit dhe të përpjekjeve për të mbështetur njëri-tjetrin në zbatimin e përgjegjë-sive tona që burojnë nga detyrimi ungjillor dhe nga bashkimi ynë sakramental në Pagëzim e Meshtari, po përgatitem shpirtërisht të shtegtoj drejt Jush në Viz-itën time Baritore.

Gjatë këtyre tre viteve, që kur m'u besua kujdesi për Kishën në Kosovë, shpeshherë ju kam takuar në bashkësitë tuaja famullitare, në shërbesat e përbash-këta liturgjike, po edhe në takimet personale që kemi pasur, Megjithatë, dëshiroj të shtegtoj drejt jush, si Bari i grigjës për t'ju takuar atje në vreshtin e Zotit, që t'ju falënderoj për punën e madhe që bëni; për t'ju takuar në ushtrimin e hirit sakramental, që të gëzo-hem me Ju për dhuratat që nxjerrin besimtarët tanë dhe t'ju bashkohem në këtë shërbim.

Dëshiroj të vij për të bashkëndarë me ju vështirësitë që i hasni gjatë përhapjes së Ungjillit në mënyrë që të bëhem i dobishëm në misionin tuaj, për t'i sjellë në dëgjues të fesë të gjithë bijtë tanë (krh. Rom 1, 5b). Dëshiroj të shtegtoj drejt jush me "zemër në dorë", që të mund të shihni brenda saj tërë dashurinë e mallin që kam për ju, pres që të më pritni dhe të më pranoni me atë dashuri që të gjithëve na bashkon në Krishtin Jezus.

Mbështetur në përvojën biblike të Popullit të Zgjedhur, mësojmë, se, për të gjetur të mirën, të cilën Hyji e ka përgatitur për bijtë e vet, nevojitet për të shtegtuar prej gjendjes aktuale drejt kërkimit me sakrificë të asaj që na është premtuar. Ky lloj shtegti-mi drejt njëri-tjetrit, nuk është ecje e pakuptimtë në shkretë drejt realizimit të një qëllimi, por ecje kuptim-plote nën përcjelljen e pranisë dhe dashurisë së Zotit (krh. Dal 14-18), që, me vuajtje dhe sakrificë, të meri-tojmë dhuratën e premtuar.

Krishti, Biri i Hyjit të gjallë, është figura më e përkryer e Atit tonë qiellor që shtegton në dashuri, nga gjendja e Tij hyjnore drejt nesh, në mënyrë që të mos na mungojë prania e Zotit e mbështetja e Tij, gjatë shtegtit tonë drejt Qiellit.

Me zell të kësaj përvoje, duam të zbulojmë në njëri-tjetrin figurën e Krishtit, rëndësinë e misionit që na është besuar, si dhe dhuratën që na është premtuar, në mënyrë që të arrijmë të mbështesim njëri-tjetrin në dashuri, gjatë shtegtit tonë në Kishë. Nën drejtimin e saj, ne ecim drejt qiellit, duke mbështetur grigjën e Atit tonë qiellor, që të dijë të mbërrijë atje.

Përvoja e shërbimit apostolik na mëson çfarë duhet të jetë dashuria dhe kujdesi i Bariut për Kishën dhe si duhet nga ajo të rrezatojë dashuria për të. Kjo dashuri duhet të burojë nga "zemra e zemrës" së Krishtit, e, me ndikimin e Shpirtit Shenjt, të derdhet përsëri në Të. *"Është e drejtë t'i kemi këto ndjenja për ju! Për të vër-tetë, unë ju mbaj në zemrën time, sepse ju të gjithë jeni pjesëtarët e hirit tim në prangat e mia, në mbrojtjen e në përforcimin e Ungjillit."* (Fil 1, 7)

Jam i lumtur që do të takohem me ju, që më mbështetni në uratë, ky do të jetë një moment hiri kur në uratë me Ju do të mund të shpreh tërë dashurinë në Krishtin. Bashkë me Ju do të lutem, që dashuria juaj të shkojë duke u rritur përherë e më me forcë në të njo-hur e në kuptim të plotë, që të keni mundësi të dalloni çka

është më e mirë, që të jeni të pastër si dielli dhe pa farë të mete për Ditën e Krishtit, të jeni përplot me fryt drejtësie që vjen nëpër Jezus Krishtin - për lavdi e nder të Hyjit. (krh. Fil 1, 9-11).

E dini mirë që ipeshkvi në Kishë e ushtron detyrën e trefishtë. Prandaj, Ju ftoj të përgatitni bashkësinë tuaj famullitare dhe të gjitha gjymtyrët e saj, që të jetë e gatshme të më presë si:

munus docenti - Shpallës i Ungjillit, dhe shi për këtë, përgjegjës për ungjillëzim dhe riungjillëzim, për mësimin e Kishës, për katekizim etj;

munus santificandi - Shenjtërues i Popullit të Zotit, së bashku me të gjithë të kushtuarit, duke qenë për besimtarë shembull shenjtërie dhe shenjtërues me fjalë, me shërbim e me jetë.



Mons. Dodë Gjergji, ipeshkv i Kosovës

munus regendi - Atë dhe Bari i grigjës, e cila më është besuar dhe të cilës duhet t'ia dëshmoj, e pastaj edhe ta ruaj të pastër fenë dhe moralin, sjelljen dhe veprimin e meshtarëve dhe të besimtarëve.

Për të arritur këtë, domethënë të kuptojmë sa më mirë porosinë e Fjalës, përforcimin në fe, ngjalljen në shpresë, nxitjen në dashuri, na nevojitet një përgatitje sa më e mirë personale e vëllezërve meshtarë, po edhe e mbarë strukturave përbërëse të bashkësisë fam-ullitare: e motrave, të Këshillit pastoral, e familjeve, e fëmijëve, e rinisë, e të moshuarve, e të sëmurëve dhe e të varfërve. Me ju të gjithë dëshiroj të bashkëndaj fenë, ungjillin, kryqin dhe shpresën në të Ringjallurin.

Me anë të kësaj vizite, Kishën tonë të ndërtuar në themelet e Apostujve (krh. Ef 2, 20), dëshiroj ta frymëzoj me Fjalën e Zotit, ta begatoj me kremti-met liturgjike, ta nxis të angazhohet në bamirësi, dhe, nëpërmjet bashkëndarjes së gjithë kësaj, të thellohem në fe e dashuri.

Mbi të gjitha, dëshiroj të jap kontribut për të për-forcuar gjithë bashkësinë kishtarë në paqe e në bash-kim. Shpeshherë dëgjohen zërat e atyre që shkaktajnë përçarje dhe shkanduj në dëm të mësimin në të cilin jeni mësuar (Rom 16, 17). Prandaj dëshiroj të vij e t'ju them sy më sy e me zemër të sinqertë se ...dëshiroj të jeni të urtë për sa i përket së mirës e të jeni të pastër nga çdo e keqe (Rom 16, 19b), që të mos bëhemi shkandull e të mos poshtërohet shërbesa jonë. Përkundrazi, në çdo gjë e dëfto-jmë veten si mbarështues të Hyjit në Shpirtin Shenjt, në

dashuri të çiltër, me fjalë të vërtetë, me fuqi të Hyjit, duke sulmuar e duke u mbrojtur vetëm me armë të drejtësisë (2 Kor 6, 4-7), flas pors me fëmijët e mi - hapeni edhe ju plotësisht zemrën tuaj! (2 Kor 6, 13).

Paqja brenda nesh na bën të shërbejmë, të shpallim dhe të jetojmë me gëzim dhe e gjithë vepra jonë të jetë më bindëse, si për ata që na binden në fe, po ashtu edhe për ata që janë në kërkim të saj. Kurse bashkimi na e krijon mundësinë që të jemi më të fortë përballë botës dhe më të sigurt në përballjen tonë me sfidat e jetës që na presin. Mbi të gjitha, bashkimi s'le në vuajtje trupin e Krishtit dhe e vë në shërbim të shen-jtërimit të botës çdo gjymtyrë të Tij. Sigurisht, edhe ju keni shumë gjëra për t'mi thënë në këtë drejtim, e mezi pres t'ju dëgjoj e të përtypë në zemrën time çdo shqetësim, sugjerim apo këshillë që ju doni të më jepni si kontribut i juaj për të mirën tonë në Krishtin.

Së fundi, o vëllezër e motra në Krishtin, gjatë këtij takimi me ju do të kemi mundësi të mirë të për-gatitemi për ta përmbyllur Vitit Meshtarak, gjatë të cilit jemi përpjekur të përtërijmë besnikërinë ndaj thirrjes, të përmirësojmë shërbimin tonë në mesh-tari dhe të rrisim besnikërinë tonë ndaj Krishtit dhe Kishës së tij.

Të dashur vëllezër e motra, kremtimi i Vitit Meshtarak është rast i volitshëm për t'u thelluar në vlerat e misionit të Meshtarit në jetën e Kishës dhe të botës. Prandaj, ju ftoj që të vazhdojmë të frymëzohe-mi nga shembulli i shenjtërve, për të cilët Kisha ditë për ditë, në përkujtimin e tyre, na i ofron si dritë që duhet të ndriçojë realitetin e kohës tonë e në të cilën duhet të gjejmë forca të reja për të ushtruar veprën e shëlbimit, që edhe ne të kemi pjesë në shoqërinë e shenjtërve në Krishtin.

Pastaj gjatë këtij viti do të ecim sipas shembullit të së Lumes Nëna Tereze dhe do të përpiqemi që sa më shumë të mbjellim në Zemrën e të gjithëve sh-embullin e dashurisë ndaj Zotit, kujdesin në dashuri për të afërmin dhe gatishmërinë për shërbim besnik në Kishë.

Në fund e përshëndes famullitarin, i cili me zell vazhdon të jetë shërbyes i të gjithëve dhe në shër-bim të nevojave tuaja; përshëndes po ashtu motrat e nderit, rregulltarët, që veprojnë brenda bashkësisë suaj me përkushtim dhe me jetën e tyre dëshmojnë se ia vlen t'ia kushtosh tërësisht jetën Zotit. Përshëndes bijtë dhe bijat e bashkësisë suaj famullitare, të cilët në mënyrë të organizuar dëshirojnë të kontribuojnë në rritjen e fesë dhe në ushtrimin e saj në jetën famil-jare. Përshëndes Këshillin e kishës që kujdeset për të përkrahur famullitarin në drejtimin e famullisë, korin e kishës që me gëzim ia bën të mundur bashkësisë t'i këndoje lavde Zotit dhe e zmadhon çdo shërbesë liturgjike në kishën tuaj; përshëndes të rinjtë, fëmi-jët dhe ministrantët që i japin jetë lterit dhe oborrit të kishës, e, në veçanti, përshëndes të moshuarit që vazhdojnë të jenë shembull i mirë brenda bashkësisë suaj, sidomos gjatë meshës së përditshme dhe lutjes së rrzuares, në Kishë. (krh. Rom 16, 1-16).

Prizren, 22 shkurt 2010

në të Kremten e Katedres së Shën Pjetrit

Mezi pres të vij dhe t'u marrë ngrykë të gjithëve,

Ipeshkvi Juaj
+ Dodë Gjergji

U kremtua festa e Zojës së Lurdit në famullinë e Stubllës

Më 11 shkurt në famullinë e Stubllës është kremtuar festa e Zojës së Lurdit, festë kjo që sivjet shënon 40 vjetorin e shugurimit të kishës famullitare. Më 2 shkurt të viti 1970 është bërë shugurimi i kishës së re në famullinë e Shën Jozefit - Stubëll.

Famullitari i atëhershëm i Stubllës Don Lluca Cirimotiq tashmë i ndjerë, së bashku me besimtarët e Stubllës vendosin

të kremtojnë këtë festë duke dashur që në famulli të kthehet paqja dhe pajtimi. Fatkeqësisht para kësaj periudhe ishte vrarë një besimtar stubllas nga një kurth e përgatitur mirë nga UDB -ja jugosllave. Në mesin e shumë të burgosurve ishte edhe famullitari i Stubllës don Dedë Ramaj, që kishte filluar ndërtimin e kësaj kishë.

Të parët tanë ishin të dobët, por djersa nuk u kursye as prej

trupit të dobët të tyre, ishin të varfër por edhe varfërinë e tyre e shndërruan në një pasuri të madhe shpirtërore, e cila vazhdon të rritet, dhe sipas statistika-ve që 40 vite në këtë Kishë janë realizuar: 2100 pagëzime; 1500 krezmime; 1210 kurorëzime; mbi 20 meshë të para të meshtarëve nga Stublla, e mbi 50 rregulltare që në atë kishë u pagëzuan dhe u edukuan për thirrjen që e ushtrojnë në shumë vende të botës; mbi 15.000 meshë e veprime tjera fetare që u kryen në atë vend të shenjt.

Festa e Zojës së Lurdit në Stubëll kremtohet në mënyrë tradicionale, dhe si askund tjetër në Kosovë e më gjerë: me meshë, rrëfime, lutje. Sikur edhe viteve të tjera edhe sivjet shume besimtar, jo vetëm nga famullia e Stubllës, por edhe famullitë tjera si nga Letnica, Binça, Ferizaj, etj, erdhën për tri ditshin e festës për të marrë pjesë në meshën shenjte dhe për tu pajtuar me Zotin duke pasur rastin të rrëfehen.

Natën e festës meshën e udhëhoqi sekretari i ipeshkvit Don Albert Jakaj me shumë meshtarë të tjerë. Pas meshës, edhe pse koha e keqe ishte procesioni tradicional rreth kishës me të Shenjtërueshmin Sakrament, për të vazhduar më pas me adhurim para Shenjtërueshmit Sakrament gjatë gjithë natës e deri në mëngjes nga besimtarët e kësaj famullie. Ishte kënaqësi të shihje se si para Krishtit dhe Nënës së Tij, besimtarët e të gjitha moshave me devocion të madh luteshin në heshtje. Nga mesnata ishte organizuar për dy orë të luteshin të rinjtë. Kisha ishte përplot besimtarë, më së shumti të rinj, dhe Don Do-



meniku mbajti një ligjëratë dhe një meditim shumë interesant sa që 2 orë shkuan shumë shpejtë, sepse ai foli shumë bukur mbi jetën dhe veprën e Zojës së Bekuar Virgjërës Mari, duke na ftuar që t'i përngajmë Asaj në jetën tonë duke thënë: "Nëna e gjithë njerëzimit na mëso të themi me ty AMEN".

Ditën e festës meshën e mëngjesit e celebroi Don Lush Gjergji, i cili para meshës e përfundoi adhurimin dhe gjatë meshës foli për huret e shumta që Stublla i ka marrë me ndërmjetësinë e Zojës së Lurdit. Ndërsa meshën qendrore e udhëhoqi Don Dominik Qerimi, udhëheqës i Qendrës edukativo pastorale Don Bosco në Gjilan. Ndrë të tjera don Dominiku tha: *Të qëndrojmë para nënës tonë, duke parë shembullin e saj që na thotë unë isha e për-vuajtur, unë isha e vogël, unë isha e thjeshtë, unë isha e varfër pikërisht për këtë arsye Jezusi erdhi në kraharonin tim.*

Festa e Zojës së Lurdit është

vërtetë festa e Zojës së Papërlyer, 11 shkurti dhe 8 dhjetori janë dy festa të pandashme, prandaj ne sot jemi mbledhur dhe të nderojmë zemrën e Papërlyer të Zojës së bekuar, prej të cilës ne mësojmë që Zoti e ka ruajtur këtë genie, këtë krijesë, që Biri i Hyjit duke u bërë njeri të mos njollosej me mëkat, sepse Jezusi në venat e gjakut të tij ka bartur gjakun e Marisë, prandaj Maria quhet edhe Eva e dyte, e cila duke e lindur Jezusin, e lind njeriu e ri, njerëzimin e ri.

Në fund të meshës e cila ishte me procesion rreth kishës, duke bartur truporen e Zojës së Lurdit famullitari i Stubllës Don Herbert Berisha falënderoi të gjithë meshtarët dhe besimtarët që kishin ardhur për ta kremtuar këtë festë, gjithashtu falënderoi edhe Korin e famullisë si dhe të gjithë ata që kishin ndihmuar gjatë atyre ditëve duke uruar që Zoja e Bekuar ti shpërblejë të gjithë me huret dhe bekimet e veta.

(Arian Ramaj – Stubëll)

Vepra muzikore në shenjë të Nënës Tereze

Më 3 shkurt 2010, Kori profesional i Filharmonisë-Operës së Kosovës nën drejtimin e dirigjentit Rafet Rudi, realizoi koncertin artistik premierë në Kishën katolike

Shën Ndou në Prishtinë.

Ky ansambël vokal profesional interpretoi një varg veprash korale. Në këtë koncert janë paraqitur vepra të njohura muzikore të kompozitorëve botëror dhe shq-

iptarë. Veprat si: "Calvary", "Pater Noster", "trosi beaux oiseaux du Paradis", "Nunc dimittis", "Voda zvir", "Në pyje vjeshta ndezi zjarre", "Ç'u mbush mali", "Ti më sy të zi", "Salve Regina" dhe "Udhëtim sonor për violinë, piano dhe kor", të shkruara nga kompozitorët: Georges Aubanel, Giuseppe Verdi, Maurice Ravel, Arvo Part, Josip Sh. Slavenski, Haig Zacharian, Vasil Tole, Vinçenc Gjini, Valton Beqiri dhe Kushtrim Gashi.

Në koncert ndërkaq interpretojnë kori dhe disa nga solistët e këtij kori: Adelina Thaçi, Dielza Sylejmani, Ergin Brahimi, Denik Prizreni, Besa Llugiqi, Sanije Matoshi dhe Riad Ymeri; solist në piano është Misbah Kaçamaku ndërsa në violinë Visar Kuçi.

Drejtori i Filharmonisë – Operës së Kosovës Baki Jashari

shprehet optimist për vlerën e këtij koncerti për vet faktin se është koncert nderimi për Nënë Terezën në 100-vjetorin e lindjes së saj. "Është spikatur që të paraqiten veprat më të mira të literaturës botërore dhe kombëtare", shprehet Jashari dhe thotë se të gjitha pikat e koncertit janë punuar me përkushtim si nga Kori, solistët e po ashtu edhe nga dirigjenti Rafet Rudi.

Kori i Filharmonisë së Kosovës është ansambël profesional (me 50 anëtarë profesionist) i cili vazhdon punën e Korit profesional të ish Radio-televizionit të Prishtinës (RTP), kor i cili veproi më shumë sukses që nga viti 1980 pikërisht nën drejtimin e dirigjentit aktual të Korit-Rafet Rudi.

(Don Albert Jakaj)



Koncerti i Filharmonisë së Kosovës në Kishën e Prishtinës

"Seminari shpirtëror" në famullinë e Gllaviçicës

Nga data 10 deri 13 mars

Mbahet "Seminari shpirtëror" nga dr. Don Prekë Lazri

Në Kishën e Shën Pjetrit e Shën Palit në Poterq Përfundon të dielën më 14 mars me Meshën e shenjtë në ora 11:00. Mirë se vini!

Don Pal Tunaj

In memoriam:

Kaloj në amshim Patër Ambroz Martini OFM, françeskan nga Shkodra

(2. 12. 1928 – 4. 2. 2010)



Të enjten më 3 shkurt 2010 në Shkodër në moshën 82-vjeçare vdiq françeskani shqiptar, patër Ambroz Martini.

Patër Ambrozi leu në Theth të Shalës, Dukagjin, më 2 dhjetor 1928.

Zhgunin françeskan e vesh në vitin 1938 në Shkodër nga duart e patër Anton Harapit.

Në vitin 1948 largohet nga Shqipëria komuniste për në Mal të Zi, me motrën dhe me vëllanë, ku do të qëndrojë 8 vjet e më pas do të udhëtojë për Itali bashkë me motrën, e cila ishte motër nderi, dhe patër Daniel Gječaj, don Zef Oroshin, don Nikollë Kimzën.

Shugorohet meshtar më 29 qershor 1957 në Itali. Pas shugurimit meshtarak vazhdon studimet pasdiplomike „Literaturën moderne“ në Firenze.

Nga viti 1970 e kemi misionar në Amerikë, Australi e Kaliforni, kurse në vitin 1974 emërohet misionar për shqiptarët në Belgjikë. Për Pashkë të vitit 2000 kthehet përgjithmonë në Shqipëri.

Mesha e dritës e patër Ambrozit u kremtua të shtunën më 6 shkurt në orën 10:00, në Kishën e shën Françeskut në Shkodër.

Të shtunën më 6 shkurt Shkodra e përcolli patër Ambroz Martinin në amshim. Në këtë varrim pothuajse e gjithë Shkodra më Malësinë e Dukagjinit kishin ardhur për ta përcjellë patrën e tyre

të dashur, patër Ambroz.

Në meshën e dritës morën pjesë një numër i madh meshtarësh, nga e gjithë Shqipëria, shumë françeskanë dhe klerikë të tjerë, motra të nderit. Këtë meshë e drejtoi mons. Angjelo Masafra, arqipeshkëv metropolit i Shkodrës, mons. Rrok Mirdita, arqipeshkëv metropolit i Tiranës, mons. Hil Kabashi, administrator i Shqipërisë së Jugut.

Meshtarë dhe besimtarë kishin ardhur edhe nga Mali i Zi dhe Kosova e vendet e tjera. Në emër të Kuvendit Françeskan të Gjakovës i pranishëm ishte patër Ndue Kajtazi.

Në përcjelljen e fundit për në atdheun qiellor kishte edhe përfaqësues të Bashkësisë Islame të Shkodrës. Predkun e rastit e mbajti provinciali i françeskanëve të Shqipërisë patër Gazmend Tinaj. Po ashtu për patër Ambroz foli edhe mons. Rrok Mirdita i cili ishte edhe nxënës i patër i tij.

Në fund të meshës një mori e madhe e popullit, trupin e patër Ambrozit e përçollën në varrezat françeskane afër kishës të Arra e Madhe. Shqipëria humbi një burrë, Kisha një meshtar, Provincia Françeskane një frat të dashur dhe një dëshmitar të vuajtjeve.

*Jepja, o Zot, pushimin e pasosur!
E i ndritë drita e pambarua
Pushoftë në Paqë!*

Karnavalet 2010 – Prizren

Karnavalet në qytetin e Prizrenit kanë një traditë të lashtë! Megjithatë këto vitet e fundit ato festohen në mënyrë paksa më të organizuar që është punë e PPCPG (Parish Prizren Caritas Pressure Group) e mbështetur nga famullia. Kjo festë është pjesë e planit vjetor të aktiviteteve të PPCPG si edhe shumë aktivitete të tjera. Edhe këtë vit po ashtu e kemi festuar këtë festë. Karnavalet e këtij viti

janë mbajtur më 13 shkurt 2010, kanë filluar nga ora 19:00 me marshin drejt sheshit Shadërvan, të udhëhequr me mbishkrimin Karnavalet 2010 dhe karrocën e Princit dhe Princeshës. Për dy

orë të tëra në sheshin shadërvan ka pasur dj muzikë dhe kanë qenë pjesëmarrës fëmijë e të rritur, të rinj nga famulli të ndryshme si dhe qytetar të Prizrenit. Festa në shesh ka qenë mahnitëse dhe ka impresionuar të gjithë pjesëmarrësit. Pas marshit në sheshin shadërvan ka vijuar



Këshilli Organizativ i Kosovës për 100-vjetorin e lindjes së Nënës Tereze

Më 11 nëntor 2009 në Prishtinë është mbajtur takimi i parë konstitutiv i Këshillit Organizativ të Kosovës për 100-vjetorin e lindjes së të Lumes Nënës Tereze /2010/. Në këtë takim punë morën pjesë: Valton BEQIRI, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Xhavit BEQIRI, përfaqësues i Presidencës, Ali PODRIMJA, përfaqësues i Akademisë së Shkencës dhe Arteve, Jusuf BAJRAKTARI, përfaqësues i Institutit të Historisë, Don Lush GJERGJI, përfaqësues i Kishës Katolike.

Ky Vit Jubilar është hapur më 10 dhjetor 2009 me Akademinë kremtores me rastin e 30-vjetorit të marrjes së Shpërblimit Nobel për Paqe të Nënës Tereze në Oslo - Norvegji /10 dhjetor 1979- 10 dhjetor 2009/.

Gjatë vitit 2010 janë paraparë manifestime të ndryshme kulturore dhe shpirtërore, me pjesëmarrje të botës së shkencës, kulturës, artit, ku parashihen botime të librave, pjesë teatrale, muzikore, java e filmit dokumentar kushtuar Nënës Tereze, si dhe seminare, simpoziume kombëtare dhe ndërkombëtare.

Qëllimi i këtyre veprimtarive është ky: ndriçimi i jetës dhe veprës së saj në dimensionet botërore, si dhe ndër shqiptarë, si dhe krijimi i kulturës së jetës dhe qytetërimit të dashurisë, shtylla këto të tërë veprimtarisë së saj të mbështetur në të vërtetë dhe në dashuri për Zotin dhe Njeriun, veçmas për të varfër dhe të rrezikuar.

Dita qendrore do të jetë në Prishtinë më 5 shtatori 2010, festa e së Lumes Nënës Tereze, ku parashihet edhe Mesha e Parë dhe bekimi i Katedrales dhe Shenjtërores në ndërtim me titull “Nëna Tereze”, me pjesëmarrje të autoriteteve të larta vendore dhe ndërkombëtare.

Veprimtaritë e tilla përforcojnë dhe begatojnë vëllazërinë gjithëshqiptare të Kosovës me Shqipërinë dhe Maqedoninë, si dhe me vendet tjera, duke krijuar kulturën e takimeve dhe të

dialogut ndërnjerëzor, zhvillimin e paqes, bashkimit në dallime, bashkëjetesës dhe faljes, gjithnjë në stilin e Nënës së Madhe – Nënës Tereze.

Deri më tani janë mbajtur këto manifestime:

Akademia kremtores në “Teatrin kombëtar” në Prishtinë me rastin e 30-vjetorit të Shpërblimit Nobel të Nënës Tereze, si dhe Shpallja e Dekretit Presidencial e Vitit të Nënës Tereze 2010 /Prishtinë, 10 dhjetor 2009/.

Koncert Premial i Filharmonisë së Kosovës në katedralen “Zoja Ndhimëtare” në Prizren /12. 12. 2009/.

Koncerti i Fakulteteve të Arteve të kushtuar 100-vjetorit të lindjes së Nënës Tereze /Prishtinë, “Salla e Kuqe”, 14. 01. 2010/.

Ekspozita e arteve figurative në Shkup dhe fillimi i manifestimeve kulturore shqiptare kushtuar Nënës Tereze / Shkup, 23 janar 2010/.

Koncert Premial i Filharmonisë së Kosovës në Prishtinë në kishë “Shna Ndou” /3. 02. 2010/.

Nga Këshilli Organizativ parashihen edhe këto veprimtari gjatë vitit 2010:

Mbarimi i shkurtit ose fillimi i marsit 2010 promovimi i librit të Don Lush Gjergjit, “Nëna Tereze, dashuria në veprim”, botimi shqip dhe anglisht.

Gjatë marsit Ekspozita e Librave në gjuhët e ndryshme të botës për Nënë Tereze, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës.

Ekspozita e foto-dokumenteve që kanë të bëjnë me jetën dhe veprën e Nënës Tereze, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës.

Gjatë prillit promovimi i librit të Don Lush Gjergjit, shkruar enkas për 100-vjetorin e lindjes së Nënës Tereze, “Nëna Tereze – Shenjtëresha e Dashurisë”, në gjuhën shqipe dhe angleze.

Gjatë muajit maj botimi dhe promovimi i veprës poetike të Nënës Tereze në gjuhën shqipe, angleze dhe gjermane, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës.

Gjatë majit maj Konkursi për Artet Pamore me temën “Jeta dhe vepra e Nënës Tereze” nga Galeria e Arteve e Kosovës.

Gjatë muajit maj “Ora e Madhe Letrare” kushtuar Nënës Tereze në Mitingun e Poezisë në Gjakovë.

Gjatë qershorit botimi dhe përmbledhja e disa librave të autorit Anton N. Berisha kushtuar Nënës Tereze.

Gjatë gushtit “Figura e Nënës Tereze në letërsi”, sesioni në kuadër të Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhë, Letërsi dhe Kulturë Shqiptare.

Gjatë gushtit përrurimi dhe emërtimi i Urës së Mitrovicës mbi Ibër “Ura e Paqes – Nëna Tereze”.

4 ose 5 shtator Filharmonia e Kosovës Koncert: *Requim i Giuseppe Verdit*, kushtuar Nënës Tereze.

5 shtator përrurimi dhe bekimi i Katedrales dhe Shenjtërores “Nëna Tereze” në Prishtinë.

5 shtator akordimi i Medaljes Humanitare Nëna Tereze nga presidenti dr. Fatmir Sejdiu.

5-10 shtator Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Jeta dhe vepra e Nënës Tereze”, Instituti i Historisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

26-30 shtator Java e filmave dokumentar kushtuar Nënës Tereze, Teatri Kombëtar.

Gjatë tetorit botimi i Foto-Albumit “Nderimi i Nënës Tereze në botën shqiptare” /Dom Ndue Ballabani, Tonin Çobani dhe Ylli Drishti/.

Gjatë nëntorit organizimi i Simpoziumit shkencor “Nëna Tereze dhe bota shqiptare”, Instituti Albanologjik i Kosovës.

Gjatë dhjetorit Promovimi i të gjitha librave të botuara mbi Nënë Tereze gjatë vitit 2010.

Koncerti vokalo-instrumental me vepra muzikore kushtuar Nënës Tereze.

Botimi i pullës postale me portretin e Nënës Tereze, Posta e Kosovës.

(Don Lush GJERGJI)

si dhe famullia implementuese e projektit famullia e Prizrenit me rininë e saj, po ashtu pjesëmarrës kanë qenë edhe rinia e minoritetit RAE.

E mirë e gjithë kësaj është se vullnetarët dhe rinia e famullive të ndryshme mund të takohen, të komunikojnë dhe shoqërohen, gjë që në të ardhmen mund t’i ndihmojë në bashkëpunim mbi fusha të ndryshme, përndryshe përfitues apo pjesëmarrës të të gjithë kësaj feste ishin afërsisht 200 veta. Festa në sal-

lën e famullisë ka vazhduar plot gjallëri dhe gëzim duke shijuar muzikën dhe shoqërimin si dhe festën e karnaveleve. Në fund të festës është zgjedhur maska më e mirë, megjithatë kemi vlerësuar nga një përfaqësues nga secili grup pjesëmarrës për maskimin që ka përgatitur. Festa ka përfunduar rreth orës 24h me kujtime dhe mbresa të paharrueshme.

Për të gjithë këtë organizim të madh falënderojmë Grupin e Vullnetarëve PPCPG, Caritasin e Kosovës dhe Caritasin Zvicëran.

(Ilir Memaj)

Benedikti XVI në mbledhjen plenare të dikasterit për familjen: fëmijët dëshirojnë të rrethohen nga dashuria e nënës dhe e babait

“Disa anëtarë të Kishës i kanë dhunuar të drejtat e fëmijëve, sjellje kjo që Kisha nuk harron e nuk do të harrojë kurrë ta dënojë ashpër”. Kështu pohoi Benedikti XVI, duke pritur në audiencë pjesëmarrësit e mbledhjes plenare të Këshillit Papnor për Familjen.

Dhimbsuria dhe mësimi i Jezusit – shtoi Papa, i cili njoftoi se javët e ardhshme do të botojë një Letër baritore, drejtuar besimtarëve irlandezë, pas disa raporteve gjyqësore mbi shpërdorimet e kryera nga njerëzit e Kishës – kanë qenë gjithnjë thirrje e fuqishme për t’i trajtuar fëmijët me respekt të thellë, kujdes e dashuri.

Kisha gjatë shekujve, duke ndjekur shembullin e Krishtit – vijoi Papa, në sa kujtonte 20-vjetorin e Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijëve – e ka pasur gjithnjë në qendër të vëmendjes mbrojtjen e të drejtave e të dinjitetit të të miturve dhe është kujdesur për ta, në mënyra nga më të ndryshmet. Por mjerisht, në disa raste – shtoi Ati i Shenjtë – disa nga anëtarët e saj, duke vepruar në kundërshtim me këtë impenjim, i shkelën

këto të drejta, sjellje kjo gjithnjë e dënueshme nga ana e Kishës.

Fjalët e ashpra të Jezusit kundër atyre, që shkandullojnë qoftë edhe një nga këta të vegjël – vijoi të pohonte Ati i Shenjtë – i impenjojnë të gjithë të mos e ulin kurrë nivelin e këtij respekti e të kësaj dashurie. Prandaj edhe Konventa mbi të drejtat e fëmijëve u mbështet me kënaqësi nga Selia e Shenjtë, pikërisht sepse përmban formulime pozitive, që kanë të bëjnë me bijësimin, kujdesin shëndetësor, edukimin, ndihmesën e fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe mbrojtjen e tyre nga dhuna, braktisja e shfrytëzimi seksual.

Përparësitë baritore për familjen, doracaku kushtuar përgatitjes për martesë, shërbimi ndaj fëmijëve dhe mbrojtja e të drejtave të tyre, janë tri temat e mbledhjes plenare të Këshillit Papnor për Familjen, që u hap sot në Romë me audiencën tek Benedikti XVI.

Në këtë takim marrin pjesë 150 anëtarë të Dikasterit të Vatikanit. Është një Këshill i përtërirë thellë kohët e fundit, pas zgjedhjes së kryetarit, kardinalit Enio Antoneli e të sekre-

tarit të ri, ipeshkvit Zhan Lafit, por edhe të anëtarëve, ndërmjet të cilëve, disa shekullarë.

Pranë tyre, gjatë punimeve, do të japin ndihmesën edhe anëtarët e tjerë, që vijojnë detyrën zyrtare; nëntë çifte të reja bashkëshortësh, përfaqësues të kontinenteve të ndryshme e shtatëmbëdhjetë këshilltarë të rinj. Kardinali Antoneli, e dëshmoi qëllimin e kësaj mbledhjeje plenare: “Vërehet gjithnjë më shumë urgjenca për përgatitjen sa më serioze të martesës, në mënyrë që të sigurohet jo vetëm realizimi i frytshëm, por edhe vlera e saj, që sot është e paparashikueshme. Duhet, prandaj, një përgatitje serioze, duke përkrahur një rrugë të gjatë, e jo vetëm doktrinale, por edhe praktike, të fesë e të jetës së krishterë. Ka edhe forma të tjera më të lehta, si kurset, takimet e shkurtra, por edhe këto duhet të kenë vazhdimësi e të përgatiten me seriozitetin më të madh, duke u mbështetur në Nxitjen Apostolike ‘Familiaris consortio’ të Gjon Palit II. Kjo – tematika e diskutimeve të sotme. Do të flitet kryesisht edhe për të drejtat e fëmijëve.”



Botohet programi i shtegtimit apostolik të Benediktit XVI në Maltë

Salla e Shtypit e Selisë së Shenjtë botoi programin zyrtar të shtegtimit Apostolik të Papës në Maltë, më 17 e 18 prillin e ardhshëm, me rastin e 1950-vjetorit të mbytyjes së anijes, me të cilën lundronte Shën Pali.

Benedikti XVI do të niset nga Aeroporti romak ‘Leonardo da Vinci’, të shtunën, më 17 prill.

Udhëtim dyditor, i ngjeshur me një sërë veprimtarish, duke nisur nga ceremonia e mirëseardhjes, që do të organizohet në orën 17.00, pak pas arrijtes, në Aeroportin Ndërkombëtar Maltez të Luasë, gjatë së cilës Papa do të mbajë edhe fjalimin e parë drejtuar banorëve të arkipelagut.

Më pas, në La Valeta, do t’i bëjë një vizitë mirësjelljeje presidentit të Republikës, në Pallatin e Mësuesve të Mëdhenj.

Në orën 19.45, do të vizitojë shpellën e Shën Palit në Rabat, ku do të lutet e do t’u drejtojë përshëndetjen të pranishmëve.

Shtegtimi do të arrijë kulmin të dielën, më 18 prill, në Floriana, ku Benedikti XVI do të kryesojë Meshën Shen-

jte, në Sheshin e Hambareve. Pas Meshës, do të kremtojë, po këtu, edhe lutjen e Engjëllit të Tënzot, për të drekuar, në përfundim, me ipeshkvijtë e Maltës dhe grupin, që e shoqëron..

Në orën 16.00 të së dielës do të largohet nga Nunciatura Apostolike e Rabatit, në drejtim të Kalkarës. Papa do të shtegtojë me anije nga Kalkara drejt Portit të Madh të La Valetë. Këtu do të takohet me të rinjtë, të cilëve do t’u drejtojë edhe përshëndetjen e rastit.

Edhe ceremonia e lamtumirës do të mbahet në Aeroportin Ndërkombëtar të Luasë, në orën 19.10. Fjalimi i fundit i Papës është pikërisht ai i lamtumirës, para nisjes drejt Aeroportit romak të Çampinos, ku pritët të arrijë rreth orës 20.45.

Është vizita e tretë papnore në Maltë, pas dy vizitave të Gjon Palit II më 1990 e 2001. I kushtohet 1950-vjetorit të mbytyjes së anijes, me të cilën udhëtonte Shën Pali në arkipelag. Sipas traditës, anija duhet të jetë mbytur në vitin 60, gjatë udhëtimit të Shenjtë drejt Romës. Apostulli i Popu-

jve – lexojmë në Veprat e Apostujve – u prit me humanitet të madh nga popullsia vendase. Këtu u ndalua tre muaj, para se të nisej për Sicili. Si u kafshua nga një nepërkë, pa asnjë pasojë, shumë të sëmurë vendas vrapuan tek ai e u shëruan.

Më 16 qershor 2005, Benedikti XVI, duke pritë ambasadorin e ri maltez pranë Selisë së Shenjtë, kujtoi rrënjët e thella të krishtera të Maltës, trashëgimi vlerash kulturore e fetare, mbi të cilat mund të ndërtohet një ardhmëri me solidaritet e paqe. Krijimi i një Evrope të bashkuar e solidare – pati nënvizuar – është detyrë e të gjithë popujve që banojnë në këtë shtëpi të përbashkët. Evropa duhet të dijë t’i harmonizojë interesat legjitime të çdo kombi, me kërkesat e së mirës së përbashkët të mbarë Kontinentit.

Malta, e pavarur nga Mbretëria e Bashkuar që nga viti 1964, numëron rreth 410 mijë banorë, 98% e të cilëve, katolikë. Që nga një maji i vitit 2004 është Shtet anëtar i Bashkimit Evropian e, nga një janari 2008, ka nisur të përdorë euron.

Takim i kryetarëve të Konferencave Ipeshkvnore të Evropës Juglindore, mbi temën

“Të drejtat dhe detyrat e pakicave katolike në vendet e Evropës Juglindore”

Nga data 25 deri më 28 shkurt, në Shisinau të Republikës Moldave u zhvillua takimi i dhjetë i kryetarëve të Konferencave Ipeshkvnore të Evropës Juglindore. Tema e këtij viti ishte: “Të drejtat dhe detyrat e pakicave katolike në vendet e Evropës Juglindore”. Nga Shqipëria mori pjesë ipeshkvi i Sapës, imzot Lucian Avgustini. Vendet e tjera të përfaqësuar janë Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Qipro, Greqia, Moldavia, Rumania, Turqia dhe Konferenca Ipeshkvnore e Shenjtorëve Çiril e Metod, ku përfshihet Serbia e Mali i Zi.

Pas Asamblesë plenare të Këshillit të Konferencave Ipeshkvnore Evropiane, që u zhvillua në Paris, në tetor të vitit të kaluar, ipeshkvijtë i kthehen temës së marrëdhënieve ndërmjet shtetit e Kishës, në kontekstin e veçantë të atyre vendeve ku katolikët nuk janë shumica e popullsisë.

“Përmes këtij takimi – pohon kryepeshkvi i Sarajevës, kardinali Vinko Puljić – duam të analizojmë gjendjen e veçantë të

Kishës Katolike në ato vende ku jemi pakicë, jo vetëm për të folur mbi të drejtat, të cilat duhet t’i kemi njëlloj me çdo institucion të njohur ligjërisht, por sidomos për të verifikuar kontributin, që katolikët mund dhe duhet të japin për të mirën e përbashkët të shoqërisë. Në veçanti – vazhdon kryetari i Konferencës Ipeshkvnore të Bosnjë-Hercegovinës – ndryshimet e shpejta në shoqëritë tona, të cilat janë sprovuar në të kaluarën nga lufta, mjerimi e forma të ndryshme totalitarizmi, kanë sjellë një proces shekullarizimi të pakontrolluar, i cili, megjithëse i ndryshëm nga shteti në shtet, paraqet elemente të përbashkëta. Sot, për shembull, familjet e vendeve tona duhet të përballojnë probleme të reja, që njiheshin pak më parë, si papunësia, emigracioni, alkoolizmi, droga dhe aborti. Në këtë kontekst, Kisha Katolike është e thirrur të favorizojë ruajtjen e vlerave tradicionale të popujve tanë, t’i ripropozojë ato e t’i forcojë”.

(Don Pal Tunaj)

Benedikti XVI kryesoi Konkistorin për shenjtërimin e gjashtë të Lumëve

Katër Shenjtorë e Shenjtore bashkëkohorë, nga tre kontinente, të lindur në gjysmën e shekullit të 19-të; ndërsa dy të tjerë, ndërmjet viteve 1400 e 1500, i përkasin këtyre dy epokave. Gjashtë të Lumët, sot në qendër të vëmendjes në Konkistorin e zakonshëm publik, kryesuar në sallën e Konkistorit të Pallatit Apostolik në Vatikan, nga Papa Benedikti XVI, i cili vendosi që Kremtimi për shenjtërimin e tyre të mbahet të dielën, më 17 tetor 2010.

Të përshkosh etapat e jetës së një Shenjtoreje ose të një Shenjtori, është një lloj si të përshkosh ngjarjet më pozitive të periudhës historike, kur këta njerëz i shërbyen Kishës, duke ndikuar fuqimisht edhe mbi zhvillimin e shoqërisë së kohës së tyre. Kjo ndodhi në Vatikan, kur Benedikti XVI hapi dhe kryesoi, përmes kremtimit solemn të Orës së Gjashtë, Konkistorin për miratimin e gjashtë Çështjeve, që kanë të bëjnë me shenjtërimin e gjashtë të Lumëve.

T'i njohim nga afër, duke nisur nga **Maria e Kryqit Meklop (1842-1909)** e cila, më 17 tetorin e ardhshëm, do të bëhet e para Shenjtore australiane. U lind në gjysmën e shekullit të 19-të, në Melburn. Australia e asaj kohe ishte një grumbull kolonish, me jetë të varfër e primitive. E varfër ishte edhe familja e vajzës, së cilës, megjithëse tejet e tërhequr nga jeta rregulltare, iu desh të hiqte dorë prej kësaj dëshire, për të mbajtur familjen. 18 vjeçe e gjejmë duke dhënë mësim në një qytet të vogël të jugut. Me famullitarin, Atë Uds, themelon shkollat e para katolike, në të cilat jepej mësim falas, duke luftuar, kështu, konkretisht, kundër plagës së analfabetizmit. Shumë shpejt me të u bashkua një grup mësuesesh, të gatshme të jepnin mësim pa pagesë. Ato u bënë bërthama e Kongregatës së Motrave të Shën Jozefit të Zemrës së Krishtit, të cilat më pas u njohën me emrin Jozefinet. Nga Nëna Meri, siç nisi të thirrej Shenjtorja e ardhshme, të gjithë mësuan t'i shkollonin fëmijët, t'i ndihmonin familjet e tyre e të bëheshin familje për të burgosurit, me të cilët nuk merrej askush. E Nëna Meri nuk kishte frikë të hynte e vetme në qelitë e dënuarve me vdekje, për të fashitur në zemrën e tyre instinktet e frikës e të urrejtjes, në orën e fundme, duke



i ngushëlluar me fjalë të qëllura e duke i dëgjuar me dashuri motre, ashtu si nuk kishte bërë askush, para saj. Në vend të njohjes së meritave, u shpërblye me shpifje. U akuzua për veprimtari armiqësore, sepse nuk pranonte t'u jepte para autoriteteve. Për fat të keq, thashethemet peshuan shumë më rëndë se vepra e dashurisë së krishterë e, në vitin 1871, ipeshkvi i Adelaides e shkishëroi, atë e motrat e saj, duke i dëbuar Jozefinet nga qyteti, për t'i kërkuar, më pas, me shumë përvujtëri, ndjesë për këtë veprim, si dhe rikthimin në qytet. Në këtë kohë Nënë Meri inkurajohet drejtpërdrejt nga Papa Piu IX, gjë që e lehtëson njohjen kanonike të Institutit të saj, të cilin e drejton, si Eprorja e parë, deri në vdekje.

I Lumi Andre Beset (1845-1937), kanadez nga Monreali, është vetëm tri vjet më i ri se Motra Meri. Jetim që në moshën 12 vjeçe, më pas emigrant në SHBA, mësohet ta nderojë në mënyrë të posaçme Shën Jozefin. Pasi rikthehet në qytetin e lindjes, hyn si rregulltar në Kongregatën e Shenjtes Kryqje e i besohet detyra e portierit të Kolegjit të Zojës së Bekuar, detyrë që do të vijonte ta kryente për 40 vjet me radhë. Do të kryente dhe detyra të tjera, si ajo e infermierit, e berberit, e kopshtarit, por mbi të gjitha, detyrën e njeriut të

Zotit. Devocioni për Shën Jozefin e ndihmoi të nxjerrë hirin e shërimeve të jashtëzakonshme e qelia e tij u bë cak i përherëshëm shtegtimesh, ku kërkonin ndihmë njerëz nga më të ndryshmit. I konsideruar si i sëmurë, që kur ishte dëshirtar, vëllai Andre vdiq në moshën 91 vjeçe, në vitin 1937. Ishte bërë aq i njohur e i nderuar, sa dita e vdekjes së tij u shpall ditë zije në të gjithë Kanadanë.

Bashkëmoshtare e Andre Beset është spanjollja **Gjovana Jozefa Cipitria i Barriola (1845-1912)**. Gjysëm analfabete, shumë shpejt do të bëhej e njohur për devocionin e saj të posaçëm ndaj Eukaristisë e Zojës së Bekuar. Fryt i kësaj bote të rrallë shpirtërore, do të ishte dashuria e jashtëzakonshme për të varfërit, me të cilët ndante bukën, veshjen, e edhe një pjesë të mirë të rrogës. Në këtë jetë plot gjallëri, nuk mund të mos i lindte ideja për t'ia kushtuar gjithë jetën Zotit e të varfërve: nisi, kështu, që në vitin 1869, punën për themelimin e Kongregatës së Bijave të Jezusit. Mori emrin Kandida Maria e u vu në krye të Institutit, që lindi në Salamankë, në vitin 1871. Simotrat e saj iu kushtuan, së bashku me të, edukimit e shkollimit të fëmijëve. E Kandida Maria, pavarësisht nga kufizimet e saj intelektuale, u bë shpirti i veprës e priu me besim të patundur

në Provaninë Hyjnore, e cila ia dëgjoi gjithnjë lutjet.

Po në gjysmën e 1800-tës, në Kazoria, pranë Napolit, lindi Julia Salxano (1846-1929). E rritur në jetimore, u bë mësuese në një shkollë fillore, ku nuk u kujdes vetëm për mësimin e fëmijëve, por edhe për edukimin e tyre shpirtëror. Ndërsa jepte mësim, organizoi laboratore të qepjes, në të cilat përgatiteshin sendet e nevojshme për kishat e varfra. E aq i madh ishte përkushtimi i saj, sa të meritonte lavdërimi jo vetëm nga autoritetet kishtare, por edhe nga ato civile. Bëri kushtet e përjetshme në vitin 1905. Pak më përpara ishte themeluar Kongregata e Motrave Katekiste të Zemrës së Krishtit. Shenjtorja e ardhshme ishte katekiste e frymëzuar e plot dashuri për të gjithë njerëzit, dashuri që buronte nga adhurimi i Zemrës së Krishtit.

Kamila Batista Varano (1458-1524) qe bijë e princit Jul Qesari nga Varano, sundimtar i Kamerinos. U rrit në një pallat, ndërmjet dëfrimeve, që ia mundësonte rangun e lartë të familjes. E pra, në këtë atmosferë të zbrazët, plot me kotësira, u ndez shkëndija, që e shtyu të kërkojë një jetë të thellë shpirtërore. Kur ishte ende 8-9 vjeçe, siç tregon vetë në një autobiografi, bëri një kusht, pasi dëgjoi predikimet e françeskanit

Domeniko nga Leonesa. Kushti ishte të derdhte një lot çdo të premte, në kujtim të Mundi-meve të Krishtit. Nuk arriti ta mbajë gjithnjë këtë premtim, për shkak të atmosferës që e rrethonte, së cilës nuk i pëlqenin lotët. Atëherë ajo vendosi të zgjidhte kuvendin, pavarësisht nga kundërshtimet e të atit. Dëshira e saj triumfoi e ajo veshi zhgunin françeskan në kuvendin e Shën Kjarës, në Urbino, duke marrë emrin motër Batista. Pasojnë vite të tëra misticismi; Mundimet e Krishtit vijojnë të jenë në qendër të jetës së saj. Ngjarjet e hidhura, që ia trondisin familjen, e detyrojnë të ikë, por pastaj rikthehet në Kamerino, ku vijon të jetojë, si abateshë, deri në vdekje, duke u bërë pikëmbështetje për të gjithë, përfshirë edhe autoritetet civile e fetare.

Tetë vjet pas vdekjes së motër Batistës, lindi në Poloni Stanisla Kazhimirçik (1433-1489). Bir i një këshilltari bashkijak e i një nëne shtëpiake, Stanisla studioi në famullinë e ngritur nga Kanonikët rregulltarë Lateranensë. Ky takim qe vendimtar për jetën e tij. Në moshën 23 vjeçe hyri në këtë Urdhër, ku u thellua me kujdes e dashuri në studimin e Biblës. Ishte njeri praktik, me ndjenjë të lartë përgjegjësie, mësues i madh i shpirtit, tejet i nderuar nga bashkëvëllezërit. Me fjalën e tij e me jetën e tij shembullore rregulltare, iu kundërvu erërave të para të humanizmit, rrymë e re mendimi, që ia mbyllte portat lartimit të shpirtit njerëzor drejt Zotit. Vdiq në moshën 56 vjeçare. Në ditët e salikimeve të tij, siç dëshmojnë dokumentet, ndodhën shumë mrekulli.

**Papa emëroi
Nuncin e ri Apostolik
në Mal të Zi**

Ati i Shenjtë Benedikti XVI ka emëruar Nuncin e ri Apostolik në Mal të Zi Shkëlqesinë e Tij Imzot Alesandro D'Errico, kryepeshkëv titullar i Karinit, Nunc Apostolik në Bosnje dhe Hercegovinë.

Bartolomeu apostull

■ PËRGATITI:
Don Marjan Marku

Në rendin e apostujve, të cilët Jezusi i ka zgjedhur gjatë jetës së tij e kemi edhe Bartolomeun apostull. (krah. Mt 10,3; Mk 3,18; Lk 6,14) Emri i tij e bartë edhe emrin e babait të tij, sepse ky emer rrjedh nga gjuha arameje: »bar Talmay«, dhe ka domethënien »biri i Talmay«.

Për Bartolomeun nuk kemi të dhëna të shumta; emri i tij paraqitet tek lista e numërimit të dymbëdhjetë apostujve dhe askund tjetër nuk është në qendër të vëmendjes. Sipas traditës është identifikuar me Natanelin që do me thënë »Hyji ka dhënë«. Natanaeli rrjedh nga Kana (krah. Gjn 2,1,2); pra është e mundshme se është dëshmitarë i mrekullisë se parë të cilën e ka bërë Jezusi në Kanë të Galileës (krah. Gjn 2,1-11). Krahasimi i këtyre dy personave e ka arsyen e vet që Natanaeli në momentin e thirrjes së tij, për të cilin na njofton Ungjilli i Gjonit dhe aty gjendet pranë Filipit, ndërsa Ungjilltarët tjerë e kanë marrë në listën e apostujve me emrin Bartolome. Natanaeli ishte ai të cilin e kishte lajmëruar Filipi se e kanë gjetur atë për të cilin kishte shkruar Moisiu në Ligj dhe Profetët: »Jezusin, birin e Jozefit, nga Nazareti« (Gjn 1,45). Siç e dimë, Natanaeli në këtë lajmërim kishte paragjykimet e mëdha: »prej Nazaretit? A mund të dalë gjë e mirë?« (Gjn 1,46a). Kjo mënyrë e refuzimit është një mënyrë e rëndësishme për ne. Ajo sipas besimit të judenjëve na bënë të kuptojmë se Mesia nuk ka mundur të vjen prej një vendi të panjohur siç ishte Nazareti (Gjn 7,42). Në të njëjtën kohë e bënë të qartë

lirinë e Hyjit i cili i befason pri-tat tona dhe ai mund ta gjendet atje ku ne fare nuk mendojmë. Në anën tjetër ne e dimë se Jezusi nuk ishte vetëm nga Nazareti por edhe nga Betlehemi, sepse aty ka lindur (krah. Mt 2,1; Lk 2,4) dhe përfundimisht ne e dimë se ai ka ardhur prej qiellit, prej Atit i cili është në qiell.

Ndodhia e Natanaelit na shtynë të mendojmë edhe një gjë tjetër. Në marrëdhëniet tona me Jezusin ne nuk duhet të jemi të kënaqur vetëm me fjalë. Filipi në përgjigjen e Natanaelit ia bëri një ftesë të rëndësishme duke i thënë: »Eja e shih!« (Gjn 1,46b). Njohja e jonë e Jezusit kërkon edhe një përjetim më të thellë: dëshmia e tjerëve është shumë e rëndësishme por gjithë jeta jonë e krishterë fillon me shpallje e cila vjen nga një apo më shumë dëshmitarë. Por pastaj ne duhet të jemi vet ata të cilët jetojmë në një marrëdhënie me Jezusin. Në një mënyrë të ngjashme dëshiro-nin edhe Samaritanët të flitnin me Jezusin drejtpërdrejt, pasi që kishin dëgjuar dëshmitë nga bashkë vëllezërit e tyre, të cilët e kishin takuar Jezusin tek pusi i Jakobit, dhe pas kësaj bisede i kishin thënë gruas: »tani nuk besojmë vetëm pse na tregove ti: vetë e dëgjuam dhe e dimë se me të vërtetë është Shëlbuesi i botës« (Gjn 4,42).

Të kthehemi mbrapa tek thirrja, për të cilën na njofton ungjilltari, se Jezusi kur e pa Natanaelin duke u afruar, i tha: »Që një izraelas të vërtetë në të cilin nuk ka dredhi!« (Gjn 1,47). Këtu është fjala për një lavd të cilin e takojmë edhe tek psalm-isti: »në shpirtin e të cilit nuk ka dredhi« (Ps 32,2). Por kjo thënie Natanaelin e bënë kureshtar dhe në mënyrë befasuese pyet: »Nga


më njeh?« (Gjn 1,48a). Përgjigjja e Jezusit nuk është menjëherë e kuptuar. Ai i tha: »Para se të thirrri Filipi, të pash nënë fik!« (Gjn 1,48b). Ne nuk e dimë çka ka ndodhur nënë atë fik? Sipas gjitha gjasave ka ndodh një vendosje në jetën e tij. Nga këto fjalë ai ishte thellë i prekur, ai kishte filluar që të kuptoj dhe të mendoj: Ky njeri di gjithçka për mua, ai e di dhe e njeh rrugën e jetës, këtij njeriu pa tjetër duhet besuar. Dhe kështu ai u përgjigj me një fjalë të qartë dhe të bukur të fesë, duke thënë: »Rabbi, ti je Biri i Hyjit! Ti je mbreti i Izraelit!« (Gjn 1,49). Në këtë dëshmi shohim hapin e parë të rrugës së besnikërisë ndaj Jezusit. Fjalët e Natanaelit ndriçojnë një aspekt të dyfishtë dhe

komplementar të identitetit të Jezusit: Këtu shihet lidhshmëria e jashtëzakonshme ndaj Hyjit Atë, ku Jezusi është biri i vetëm tij por edhe lidhshmërinë e tij ndaj popullit të Izraelit, ku asi pranohet si mbret i tyre dhe ky titull i përshtatet Mesisë të cilin e priste populli i judenjëve. Ne kurrë nuk guxojmë ti harrojmë këto dy elemente të cilat janë të rëndësishme për jetën tonë fetare.

Mbi jetën apostolike të Bartholomeut (Natanaelit) nuk kemi të dhëna të sakta. Sipas historianit Eusebius i cili kishte jetuar në shekullin e katërt ai na njofton për veprimin e tij në Indi (Krah. Hist. eccl., V,10,3). Në traditën e mëvonshme prej kohës së mesjetës janë zgjeruar

thëniet për vdekjen e tij për të cilin thonë se ka qenë i repur deri sa ishte gjallë dhe nga kjo kohë bëhet edhe i njohur. Në kapelën e Sikstinit ku kishte punuar piktori i njohur Mikelangelo, Shën Bartolomeun e kishte pikturuar duke e mbajtur lëkurën e tij në dorë të majtë. Reliktet e tija gjenden në Romë në Kishën e Shën Bartolomeut në ujdhesën Tiber: Këtë relik të kishte sjell mbreti gjerman Otto i III, në vitin 983. Për fund mund të themi, edhe pse kemi informata të pakta për jetën e tij, Shën Bartolomeu qëndron para nesh për të na treguar se si duhet besuar në Jezu Krishtin dhe si duhet jetuar me të në jetën e përditshme.

“ Njohja e jonë e Jezusit kërkon edhe një përjetim më të thellë: dëshmia e tjerëve është shumë e rëndësishme, por gjithë jeta jonë e krishterë fillon me shpallje e cila vjen nga një apo më shumë dëshmitarë. Por pastaj ne duhet të jemi vet ata të cilët jetojmë në një marrëdhënie me Jezusin. ”



KRESHMËT - Kohë urate, flijimi dhe bamirësie!


■ SHKRUAN:
Don Robert JAKAJ

Fjala Krezhëm vjen prej latinishtes *quadragesima* që do të thotë 40 ditë. Në greqisht *sarakoste* që do të thotë e katërdheta (e dyzeta), në krahasim me *pentekoste* e pesëdhjeta ditë. Periudha e kreshmëve përbëhet prej 40 ditëve që u paraprijnë Pashkëve. Kjo kohë thekson që i krishteri të përqendrohet në pendimin për mëkatet dhe pajtimin me Zotin e njëri tjetrin. Të Mërkurën e Përhime besimtarëve u bëhet një kryq në ball (ose në kokë) me hi. Ndërsa bëhet kryqi meshtari thotë: „Kujto o njeri se hi ke qenë e hi ke për t'u bërë“ (Zan 3,19). Hiri bekohet përpara nga meshtari dhe stërpiket me ujë të bekuar. Ky bëhet prej palmave të djegura që janë përdorur të Djelën e Larit të vitit mëparshëm. Përdorimi i hirit ka vështrim pëndese në Bibël. Në Besëlidhjen e Vjetër përmendet në disa vende. Jobi i përhitur bën pendesë për mëkatet e veta (Job 42,6). Danieli profet është lutur me agjërime i përhitur (Dn 9,3). Kur profeti Jona predikon popullit Ninive për ndëshkimin e Zotit, mbreti pagan bën pendesë duke veshur rroba të punuara prej thesi ulur në grumbull hiri (Gjn 3,10). Kur mbreti Ahasuerus urdhëron të gjithë hebrenjtë të vriten, Mordekai i shqyen petkat e veta dhe i përhirë pastaj vishet me petk thesi, të njëjtën gjë bëjnë të gjithë hebrenjtë nëpër krejt vendin (Ester 4,1-3). Jeremia dhe Ezekieli profet përmendin të mbajturit zi me hi (Jer 6,26; Ez 27,30). Gjithashtu në Besëlidhjen e Re Jezu Krishti përmend hirin si shenjë i pendesës në rastin e Tirit dhe Sidonit (Mt 11,21).

Pse pikërisht 40 ditë?

Numri 40 përsëritet shpeshëherë në Bibël si në Besëlidhjen e Vjetër ashtu në Besëlidhjen e Re. Në Librin e Përtirjes (8,2-4) theksohet 40 vjet që populli i Izraelit ndenji në shkretëtirë. Në Librin e Daljes (24,18), Moisiu ka qëndruar 40 ditë në malin Sinai para se Zoti t'ia jepte Dhjetë Urdhërimet. Në Librin e Mbretërve (19, 8), Elia profet ka ecur 40 ditë e net për në malin Horeb. Gjithashtu në Besëlidhjen e Re Jezu Krishti agjëron për 40 ditë e net. Kjo mund të jetë influenca kryesore, së bashku me 40 orë që Jezu

Krishti ka ndenjur në varr. Sikur 50 ditë pas Pashkëve (deri në festën e Rrëshajave) të krishterët brohoritnin e gëzonin duke u lutur në këmbë, ashtu Kreshmët (quadragesima) 40 ditë ka qenë e caktuar për agjërime e pendesë. Për të patur 40 ditë, Kreshmët fillojnë të Mërkurën e Përhime dhe mbarojnë të Enjten e Madhe. Në këtë kohë bëhet agjërime (Mt 6, 16-18), lëmoshë (Mt 6, 2-4) dhe uratë (Mt 6, 5-6). Këto vepra nuk bëhen për t'u parë nga të tjerët (Mt 6,1) por, pas rrëfimit të mirë, bëhen pendesë për mëkatet tona. Dikur për 40 ditët e kreshmëve të krishterët kanë ngrënë vetëm njëherë në ditë edhe atë në darkë. Mishi dhe bylmeti kanë qenë të ndaluara. Në kohën tonë këto detyrime janë lehtësuar në dy ditë agjërime, të Mërkurën e Përhime dhe të Premtën e Madhe. Mishi është i ndaluar për çdo të premte. Agjërime duhet të bëhet duke iu shmangur epsheve, dëfrimeve, grykësisë, fyerjeve, inatit, smirës e mëkateve të tjera. Të gjitha sakrificat që bëjmë në këtë kohë na ndihmojnë të përqendrohemi më tepër në zbatimin e Ligjit të Zotit. Duke marrë sakramentet shpesh, na ndihmojnë për shëlbimin e shpirtit tanë dhe u ndihmojmë të tjerëve në nevojë. Të premteve gjatë Kreshmëve, të krishterët bashkohen në kishë dhe me uratë e përkushtim përcjellin Udhën e Kryqit. Mundimet dhe vdekja e Jezu Krishtit në Kryq të Kalvarit na ndihmojnë t'i ndërrojmë drejtimit e gabuara të jetës sonë në rrugën e vërtetë të Krishtit Zot. Kryqi i Krishtit na mëson ne si me qenë të krishterë më të mirë dhe duke i pranuar edhe ne kryqat tanë, sikur Ai, të mund të kuptojmë dashurinë e Tij për ne. Të Premtën e Madhe, të pranishmit e shohin Jezu Krishtin duke bartur Kryqin dhe në të njëjtën kohë trishtohen prej frikës së kryqeve të tyre, kurse në anën tjetër, Jezu Krishti e pranon Kryqin me kënaqësi. Kryqi për Të është mjeti i shëlbimit, i hirit dhe i dashurisë së Tij për Atin. Një herë tjetër, kur Jezusi e shëroi të verbrin i tha: „A mund të shohësh gjë?“ Ai u përgjigj: „Unë shoh disa njerëz, por duken sikur lisa që lëvizin“. Edhe ne mund të bëhemi të verbër prej mëkateve dhe shohim Krishtin e ngarkuar me Kryq sikur të ishte një lis duke ecur drejt vdekjes së tij. Kur Krishti e merr Kryqin në krah, Ai përsëri me dorën e vet na shëron duke na këshilluar: „Edhe në qoftë se nuk sheh çka Zoti të ofron prej



momentit në moment, merre kryqin dhe mbaje, që kur të jesh në vështirësi Zoti mund të tregojë dashurinë për ty“. Gjatë Kreshmëve duhet ta dëgjojmë zërin e Krishtit në Kryq kur thotë: „Kam etje“. Ai ka etje për shëlbimin e shpirtit tanë. Pra, të kemi edhe ne etje për Të që të kthehemi kah Ai që është burimi i jetës.

Kreshmët në Katekizmin e Kishës Katolike (KKK)

Katekizmi i Kishës Katolike (KKK), përmend Kreshmët vetëm 3 herë: në numrat 540, 1095 dhe 1438.

Në nr. 540 kur KKK flet për Tundimin e Jezusit në shkretëtirë ku shpjegohet se djalli është munduar ta tundojë Jezusin duke u përpjekur ta bëjë t'i bijë mohit qenies së tij si Biri i Hyjit, gjë që nuk ka arritur sepse Jezusi, Adami i Ri na ka shpëtuar të gjithëve pikërisht me dëgjesën e tij kundrejt Atit dhe na ka bërë të gjithëve Bij të tij në të, përfundon KKK duke thënë se “Kisha çdo vit i bashkohet misterit të Krishtit në shkretëtirë me katërdhjetë ditët e Kreshmëve”. Ditët e Kreshmëve si ditë pendese përkojnë saktësisht me ditët e agjërimit të Jezusit në shkretëtirë, janë pikërisht dyzet (kuptohet, pa numëruar të dielat; dhe dita e diel në asnjë mënyrë nuk mund të shndërrohet në ditë pendese). Në imitim të Jezusit, i krishteri gjatë Krezhmëve verifikon dhe forcon birësinë e vet me Atin.

Në nr. 1095 KKK tregon se Kisha sidomos gjatë kohërave të forta liturgjike, ndër të cilat është edhe Koha e Kreshmëve, me ndërmjetësinë e Shpirtit Shenjt përgatit të krishterët për ta pranuar Krishtin.

Duke qenë se Kreshmët përgatisin për kremtimin e Misterit të Pashkëve, mund të thuhet se gjatë Kreshmëve liturgia na ndihmon të marrim vetëdijen e të mirave që na presin dhe që në liturgji kremtojmë për Pashkë.

Në kontekstin e shpjegimit të Sakramentit të Pendesës, në nr. 1438 KKK flet për kohërat dhe ditët e pendesës gjatë vitit liturgjik, ku thekson se kreshmët janë kohë e përshtatshme për “ushtrime shpirtërore, liturgji pendestare, shtegtime (pelegrinazhe) në shenjë pendese, heqje të vullnetshme siç është agjërime dhe lëmosha, bashkëndarja vël-lazërore (vepra bamirësie dhe misionare).

Kjo është gjithashtu një kohë kur besimtarët janë të ftuar të marrin sakramentet, sidomos Sakramentin e Pendesës dhe të Kungimit; t'i shtojnë uratët, sidomos Ruzaren e Zojës së Bekuar; të pajtohen dhe të bashkohen me njëri tjetrin.

“Ati yt që sheh në fshehtësi do të të shpërblejë!”

Kjo fjalë e Jezusit që është në të njëjtën kohë edhe mësim edhe premtim, përveç liturgjive të ndryshme pendestare dhe lutjeve intensive që bëhen, është në njëfarë mënyre shenja dal-

luese e kreshmëve. I krishteri ka shpresë të madhe në këtë fjalë të Jezusit që na mëson se Ati na shikon dhe na shpërblen. Kështu ne mbushemi me shpresë të pastër dhe u japim kuptim veprave tona që duam t'ia kushtojmë Zotit si fli në këtë periudhë pendese.

Shikimi i Atit i drejtohet fshehtësisë dhe fshehtësia është kushti për shpërblim. Fjalën fshehtësi mund ta marrim së paku në dy kuptime: se shikimi i Atit është shumë diskret dhe nuk bën shumë bujë, është misterioz, ai sheh disi si prej së largu dhe vetëm feja e vërtetë mund ta pranojë këtë shikim; gjithashtu edhe se ky shikim është i interesuar për intimitetin e njerëzve dhe jo për veprat e jashtme të tyre nëse janë të mbyllura në vetvete. Veprat e jashtme meritojnë shpërblim nëse janë shenja konkrete që tregojnë një vendim të brendshëm të prerë dhe serioz për kthim kah Zoti. Ata duhet të shprehin fenë e besimtarit që për ta jetuar jetën në mënyrë autentike duhet ta dhurojë atë, ta jetojë për të tjerët. I krishteri ia dhuron vetveten Hyjit dhe të afërmeve, Hyjin dhe të afërmit i ka në qendër të vëmendjes. Kurdo që vepron, mundohet të shprehë dashurinë pa rezervë që ka për Hyjin dhe për të gjithë njerëzit.

Kur veprat e njeriut shprehin vetëm ego, ato shprehin interes vetëm për vetvete dhe i përçmojnë krejtësisht njerëzit. Në pamje të parë edhe mund të duken

të shenjta, por nëse shprehin dashurinë e njeriut për vetvete, ata vetvetiu eliminojnë të tjerët dhe shndërrohen në veprime gati vrastare.

Veprat e Kreshmëve duhet të shprehin edhe përlulësi dhe kush i bën këto vepra e pranon vetveten si krijesë të Zotit. Kur njeriu e zbulon vetveten si krijesë, gjen se është shumë i vogël, i padenjë për ekzistencë dhe për të gjitha të mirat që ka. Zbulimi i vetvetes si krijesë e Zotit e padenjë por e dashur prej tij ndihmon secilin ta krijojë një imazh të drejtë për vetveten, të mos mbivlerësohet e të mos nënvlerësohet, por të vendoset në vendin që i takon. Kjo lejon edhe pranimin e dinjitetit të barabartë midis njerëzëve në kuptimin që të gjithë njësoj janë krijesa të Zotit: kush bën vepra pendese është i përqendruar tek Hyji, rrugë drejt të cilit janë edhe flitë.

Nëse i krishteri dëshiron që të jetë shembull për të tjerët, do të mundohet të jetë shembull përvujtërie: “Mos të dijë e majta çfarë bën e djathta, që lëmosha jote të jetë e fshehtë” (Mt 6,3). E përvujtëria është një ndër frytet e para të pendesës kreshmore: është kontradiktore që dikush që bën pendesë të ‘shesë mend’ për pendesën që bën. Pendesa është një gjë krejtësisht intime dhe dallon prej njeriut në njeri qoftë në formë qoftë në intensitet, varësisht prej nevojave dhe mundësive që njeriu ka. Edhe pse nuk hynë në sferën e sekretit, pendesa duhet të mbetet gjithmonë krejtësisht personale, edhe në rastin kur një pendesë të caktuar ta vendosë një bashkësi e tërë.

Kemi edhe një fryt tjetër shumë të madh dhe të rëndësishëm të pendesës kreshmore: religjioziteti autentik. Ka porositur Jezusi: “kur të agjëroni, mos u mërrolni porsì shtiracakët, të cilët marrin një hije të rëndë në fytyrë për t’u treguar njerëzve se agjërojnë” (Mt 6,16). Besimi në Zotin mund të shprehet edhe publikisht dhe shpesh shndërrohet në dëshmi të madhe për ata që akoma nuk besojnë ose e kanë shumë të vështirë për të besuar dhe për ta shprehur fenë. Megjithatë, kjo shprehje publike e besimit assesi nuk duhet të jetë hipokrite, nuk duhet të gjykojë as të paragjykojë nivelin fetar të të tjerëve. Aq më pak lejon pretendime të tepërta për religjiozitetin personal. Nëse kemi fe, kemi një hir prej Zotit. Me këtë hir krenohemi, patjetër, porse nuk jemi mendjemëdhën! Një hir i tillë kërkon prej nesh përgjegjësi shumë të madhe. E nga ana tjetër, fytyrat e mërroluna – shpesh edhe fytyrat shumë të qeshura – nuk janë tregues të sigurt të religjiozitetit autentik. Njeriun nuk e bëjnë besimtar serioz fjalët e mëdha dhe premtimet e shumta, as edhe kërkesat radikale që njeriu mund t’ia bëjë vetes dhe të tjerëve, por marrëdhënia e vërtetë që ka me Jezusin.

Në këtë marrëdhënie me Jezusin duhet ta kuptojmë edhe kohën e Kreshmëve.

„Kthehuni, e besoni Ungjillit!”

Për çfarë na shërbejnë Kreshmët? Na shërbejnë për t’u përgatitur për Pashkët, të kalosh nga vdekja në Ringjallje. Në ritin latin kreshmët fillojnë të Mërkurën e Përhime dhe kanë një kohëzgjatje prej dyzet ditësh (pa i numëruar të dielat).

Kjo Kohë e Shenjtë na kujton qëndrimin e Zotit tonë Jezu Krishtit në shkretëtirë për dyzet ditë duke u lutur dhe agjëruar para se të fillonte jetën dhe veprimtarinë e tij publike.

Mbas kreshmëve kemi Javën e Madhe. Java e Madhe fillon me të Dielën e Larit duke përfshirë edhe treditëshin e Pashkëve: Të Enjten e Madhe, Të Premten e Madhe, dhe të Shtunën e Madhe, ku kulmin e saj e arrin me celebrimin e Pashkëve të Zotit dhe Pashkëve tona personale.

Tashmë ekziston edhe një pashkë personale do të thotë që edhe unë personalisht duhet të kaloj (si Jezusi) nga vdekja në jetë, nga situatat e vdekjes në situatat e jetës, nga mënyra e të menduarit, e të folurit, të reagimeve negative, në mënyrën e të menduarit, e të folurit, e reagimeve pozitive sipas Ungjillit.

Shumë herë në jetën tonë, pasi kemi venë re se kishim gabuar, kemi marrë vendim se duhet të ndryshojmë sjelljen tonë. Dhe koha e Kreshmëve është koha e së vërtetës: është rast për të vërejtur nëse kemi gabuar, dhe për të marrë vendim të ndryshojmë jetën tonë. Duke na kujtuar pagëzimin tonë, kjo kohë na fton për t’u kthyer tek Zoti. Në këtë mënyrë na përgatit për kremtimin e madh të misterit të Pashkëve, domethënë të vdekjes dhe ngjalljes së Zotit tonë Jezu Krishtit. Kremtimi i këtij misterit na mëson se nuk ka ngjallje përveçse për ata që janë të gatshëm të vdesin. Me fjalë të tjera, jeta e re me Krishtin e ngjallur është vetëm për ata që janë të gatshëm të vdesin për mëkatet e tyre, sikurse edhe vetë Jezusi ka vdekur për mëkatet tona.

Pra Kreshmët na ftojnë të përsërisim hirin e pagëzimit: të pastrohemi nga mëkati, për t’u bërë “njeriu i ri”. Vetëm mëshira e Zotit mund të na pastrojë nga mëkati (në sakramentin e rrëfimit). Por Kreshmët janë ftësë edhe për të treguar konkretisht pendesën tonë nëpërmjet agjërimit, lutjes e veprave të bamirësisë: që konsiderohen si tri forma tradicionale pendese.

Pas përmbytes, Zoti bëri besëlidhje me Noehin. Bukuria e ylberit, sikurse dëftohet në ngjyrat e tij dhe në formën e tij që nga qielli zbret drejt tokës, bëhet shenjë e kësaj besëlidhjeje të bukur, që e bashkon tokën me qiellin, njeriun me Zotin. Dhe Kreshmët janë një ftesë për një fillim të ri, një ftesë për të hyrë

“Zbulimi i vetvetes si krijesë e Zotit e padenjë por e dashur prej tij ndihmon secilin ta krijojë një imazh të drejtë për vetveten, të mos mbivlerësohet e të mos nënvlerësohet, por të vendoset në vendin që i takon.”

në bukurinë e kësaj jete të re, që na bën pjesëtarë në jetën e vetë Zotit.

Shkretëtira, në Shkrimin Shenjtë, ka dy aspekte apo dimensionë. Është vend tundimi – si edhe populli hebre ishte tunduar në shkretëtirë. Por është gjithashtu vend takimi me Zotin – në shkretëtirë populli hebre ka përjetuar praninë dhe dashurinë e Zotit, i cili bëri besëlidhjen me popullin, dhe i dha ç’të hajë e ç’të pijë. Në shkretëtirë Jezusi ka agjëruar, është lutur, dhe në këtë mënyrë është përgatitur mirë për të shpallur Lajmin e Mirë e ardhjes së Mbretërisë së Hyjit. Por edhe për Jezusin, shkretëtira ishte vend tundimi.

Megjithatë, në luftë me djallin, Jezusi doli fitues. Jeta jonë është një eksperiencë e tillë. Jemi “në shkretëtirë”, ku kemi mundësi të takohemi me Zotin. Por jemi vazhdimisht të tunduar nga djalli. Kush do të fitojë, ne (me ndihmën e Zotit) apo djalli? Varet sa seriozisht do të pranojmë ftesën e Jezusit: “Kthehuni, e besoni Ungjillit!”

„Ky është Biri im. Atë dëgjoni!”

Kemi parë se kreshmët është koha që na nxit për pendesë dhe na kujton pagëzimin tonë, që është “sakramenti i fesë”: ashtu e kanë quajtur mësuesit e Kishës që nga koha e lashtë. Mirëpo tani të shohim se çfarë është feja.

Abrahamin ne e quajmë “Ati ynë në fe”, dhe me arsye. Zoti e thirri për të shkuar në një vend

të panjohur. Abrahami besoi në këtë fjalë dhe e dëgjoi Zotin. Zoti i premtoi se do të nxjerrë prej tij një fis të madh, edhe pse ai dhe gruaja e tij ishin të shtyrë në moshë. Abrahami besoi. Dhe e dëgjoi Zotin kur ky kërkoi prej tij t’i flijonte djalin e tij të vetëm, Izakun. Tri herë me këmbëngulje shkrimet bibilke pohojnë se Izaku ishte “djali i vetëm” i Abrahamit: me të vërtetë, një provë e madhe për Abrahamin! Por ai beson, nuk dyshon: Zoti është besnik, dhe nuk e braktis atë që, me fe, lëshohet në duart e Provanisë së tij. Nuk është e vështirë, pra, të kuptojmë se biri i vetëm i Abrahamit, Izaku, është krahasuar me Jezusin, biri i vetmi i Hyjit, që Hyji Atë e dorëzoi të bëhej fli për ne. Shën Pali në Leximin e dytë pohon këtë të vërtetë për të vënë në pah dashurinë e Zotit për njeriun mëkatar: “Ai as Birin e vet nuk e kurseu, por e dorëzoi të flijohet për të gjithë ne”. Nga kjo e vërtetë, Pali nxjerr një përfundim: Atëherë duhet të kemi aq shumë besim në Hyjin, që na përkrah, sa që nuk do të kemi frikë nga asgjë që mund të jetë kundër nesh. Përveç kësaj, kemi gjithmonë Jezusin, i cili “ndërmjetëson për ne”.

Ndërkohë Jezusi mbi malin e shndërrimit mori me vete tre apostujt: Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin. Janë të njëjtit që, më vonë, e kanë shoqëruar Jezusin në kopshtin e Gjetsemanit. Por ndërsa mbi mal, fytyra e Jezusit u shndërrua dhe shkëlqeu por si dielli, në kopsht u shëmtua

duke djersitur gjak. Janë dukur gjithashtu, afër Jezusit, Moisiu dhe Elia, dy persona shumë të rëndësishëm në Besëlidhjen e Vjetër.

Mirëpo mbi mal, Moisiu e takoi Zotin që i dha dhjetë urdhërimet. Në shkretëtirën, Elia e takoi Zotin, i cili e forcoi përballë armiqve të tij. Për t’u bashkuar me Krishtin mbi malin e shndërrimit, dhe me vëmendje të dëgjojmë çka do të thuhet atje. Çka do të dëgjojmë është më e rëndësishme sesa çka do të shohim. Sepse do të dëgjojmë zërin e Hyjit Atë, i cili do të thërrasë: “Ky është Biri im i dashur: atë dëgjoni!”

Ngjarja e shndërrimit të Jezusit mbi mal është një hyrje ose përgatitje për misterin e Pashkëve. Do të shohim fytyrën e bukur të Krishtit të shndërruar, të ngjallur; por së pari duhet ta shohim të shëmtuar: është fytyra që do të djersitë gjak dhe do të rrahet. Mos ta përsërisim gabimin e Pjetrit, i cili, kur e pa fytyrën e bukur të Krishtit mbi mal, i tha: “Është mirë të qëndrojmë këtu!” – por kur e pa fytyrën e shëmtuar e Krishtit plot me gjak, ka thënë: “Nuk e njoh!” – dhe u shmang.

Dhe pikërisht feja do të thotë të përballosh provat e jetës, si Abrahami. Do të thotë të jesh gjithmonë me Krishtin, në çdo kusht. Vërtet, nuk ka ngjallje përveç për atë që është i gatshëm të vdesë! Për crucem ad lucem – nëpërmjet kryqit drejt dritës.

I pafajshmi Jezu Krisht

...Ti, i pafaji, dhunisht kje traththue,

Ti, i pafaji, n’krygjë mberthye!

Po shka u bane? Pse deshten me shfrye?

Kje dashtenija: që i vetmi gabim!

Kur t’jesh kapun nder rrethet e epra,

Kur ti t’kapes, o Zot, n’lumnin t’ande,

Me e qyrrë dhimshem

ket zemer deh! t’kande,

Ban qi t’gzojë njaq sa sot’kah t’don.

Pshtove, pshtove, i pergjegjet ktij Krishti

Ditt shëlbimi per t’gjith kan ague;

Shi n’dit t’sodit do t’vish ti me gzue

Bashkë me mue njat lumni qi s’maron!

Kryqëzimi

Po troket çekani

Po kërcet mejdani,

Dor’ e këmb’ i çpon,

Krishtin kryqëson.

Me tërbim goditin

Me gjëmim e ngjitin

Turma ulërin

Nëna blegërin.

Çdo peronë plagë

Përvëlon si flagë

Çurka gjak buron

Fryhet dhe pikon.

Kryqet ngulen, shtisen,

Tallen, qesëndisen;

Sipër Kryqe tre,

Tri Mari për-dhë.

475-vjetori i themelimit Motrave Engjëll

■ SHKRUAN:

**Bashkësia e Motrave
Engjëllore të Shën Palit,
Prizren**

Themeluesi i Motrave Engjëllore të Shën Palit është Shën Anton Maria Zakaria, i cili u lind në Kremonë të Italisë në vitin 1502, nga babai Lazëri me prejardhje Markeze dhe nëna Antonjeta Peskaroli.

Edukatën e parë Antoni e mori nga mjedisi familjar sidomos nga prehuri i nënës e cila në moshën 18 vjeçare mbeti e vej.

Kjo grua e fortë dhe e devotshme e mohoi martesën e dytë dhe iu kushtua plotësisht edukimit të Antonit të vogël.

Shën Antoni si i ri iu kushtua Zonjës së Bekuar. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në vendin e lindjes (Kremonë).

I shtyrë nga thirrja (zgjedhja) për të varfrit e të vuajturit, pasi që studioj filozofin në Pavia para se të fillonte studimet e Mjekësisë në Universitetin e Padovës, 18 vjeçar mohon trashëgimin e të parëve e të babait të tij në favor të së ëmës. Student i shkëlqyeshëm e i palodhshëm diplomohet në mjekësi në vitin 1524 në moshën 22-vjeçare, kthehet në Kremonë duke gjetur vend pune në Kolegj po të atij qyteti. Po të njëjtin vit merret me shërimin e të sëmurëve gjatë një epidemie të tmerrshme me sëmundje infektive.

Apostull i Krishtit

Me dëshirën e flaktë që tu sjell Krishtin, shpirttrave të etshëm për Hyjin, në Kishën e Shën Vitalit i mbledh, fëmijët, të rinjtë, burrat dhe grat duke ua shpallur Fjalën e Zotit përmes Katekizmit.

Kështu që profesionin e tij të mjekësisë e konsideron një mjet për të ndihmuar të afërmin jo vetëm për shërimin fizik por edhe për shërimin shpirtëror, duke hapur dyert e shtëpisë (pallatit) të tij të gjithë të varfërve të Kremonës.

Bashkëqytetarët e tij e quajnë “Atë i atdheut” dhe “Engjëll në tokë”.

Dashuria për Krishtin e Kryqëzuar

Në kuvendin e Dominikanëve në Kremonë, e takon dhe e zgjedh si Atë shpirtëror Atë Ba-



tista Carioni (dominikan), i cili e udhëheq që ta zbuloj Krishtin e Kryqëzuar përmes letrave të Shën Palit dhe të dhurohet krejtësisht Zotit.

Kështu vendos që t'ia kushtojë jetën e tij Jezusit e të bëhet meshtar. Më 20.2.1529, zgjedh rrugën e meshtarisë.

Ndërkohë që Atë Batista ia kishte dorëzuar detyrën si kapelan i Konteshës Ludovika Torelli, Antoni frekuentoi me entuziazëm njërën ndër qendrat me të mëdha fetare në Milano, Oratori

“Dituria e Amshuar” (L'Oratori dell' Eterna Sapienza) në të cilin takon dy markez milanez, Bartolomeo Ferrari e Giacomo Antonio Morigia, edhe ata dy, si Antoni, ishin të orientuar (të drejtuar) për rinovimin shpirtëror.

Antoni, me Ferraren e Morigin, bën një marrëveshje miqësie që jep jetë themelimit të tri familjeve rregulltare, të quajtur me të njëjtin emër: “Bijtë e Shën Palit Apostull” që janë:

- Klerikët rregulltar të Shën Palit (Barnabitët)
- Motrat Engjëllore të Shën Palit (jashtë klauzure) dhe
- Laikët e Shën Palit.

Themeluesi thoshte: kushtojeni kohën tuaj të lirë pranë të Kryqëzuarit, duhet ti flisni Jezusit në Kryq për gjithë atë që ju përket, kërkoni këshilla prej të tjerëve.

Për të lëkundur opinionin publik Anton Maria Zakaria dërgon Barnabitët dhe Motrat Engjëllore nëpër rrugë të Milanos për të bërë pendesë dhe për të dëshmuar Krishtin.

Që nga ajo kohë iu jep rëndësi disa veprave kishtarë: vënien solemne e publike të 40-të orëve për adhurimin e të Shënjtërshmit Sakrament, çdo të premte në orën 15:00 të bien kambanat për të kujtuar vdekjen e Jezu Krishtit, shpalljen e fjalës së Zotit në Kisha, në rrugë, në konferenca shpirtërore të përditshme, apostolati i drejtimit shpirtëror, pjesëmarrja më e shpeshtë në Kungim të Shenjtë etj.

Anton Maria Zakaria ka qenë i definuar “një pararendës” i Koncilit të Trentos, sepse së bashku me të bijtë e tij dhe me bashkëpunëtorët e tjerë (në mënyrë të veçantë në Lombardi e Veneto, ku zhvillonte apostullatin e tij) përgatiti në Kishë një reformim radikal dhe të shenjtë, me mund dhe me vuajtje, duke e flijuar rinin e vet, për t'ia dhuruar një pamje të re. Sepse në vitet e 500-ta çdo gjë ishte për tu ripërtërirë; jeta shpirtërore në qytet ishte zbehur; Dioqezat ishin pa Barinj; Kleri ishte pa formim dhe përgatitje teologjike, morale dhe shpirtërore; Manastiret dhe Kuvendet ishin të mbushura me shumë vajza të pafat, se sa me virgjëra të kushtuara.

Në këtë situatë të mjerimit moral, Anton Maria Zakaria, bashkë me të bijtë e tij, ishin

të pranishëm ku dashuria dhe nevojat e thërrisnin; vraponte pa pushuar nga një qytet në tjetrin, pa vënë re lodhjen fizike, dëshironte si Shën Pali të përhapte apostullatin e tij “deri ku Krishti i kishte urdhëruar”.

Në moshën 36 vjeçare pas një jete të shkurtër por të thellë e të plotë me Zotin, duke lajmëruar që i mungonin forcat bën kthim në vendlindje të vet e vdes me 05.07.1539 në krahët e së ëmës së tij.

U shpallë Shenjtë nga Papa Leoni XIII me 27.05.1897 është i pari mjek i shenjtëruar në kohën moderne. Papa Pali VI ia vënë titullin “Pajtor i Mjekëve”.

Kongregata

Kongregata e Motrave Engjëllore të Shën Palit u aprovua nga Papa Pali i III me 15.01.1535 në Milano të Italisë.

Në Milano, gjatë kapitullit të cilat e mbanin me themeluesin Shën Anton Maria Zakaria, diskutonin së bashku se çfarë emri do ti vënin Kongregates.

Një novicje 16 vjeçare u ngrit duke thënë: “përse nuk ja vejmë një emër që të jetë program i jetës sonë? Do të ishte mirë që të quhemi ‘Engjëllorë’ që të jemi si engjëjt në adhurim dhe lutje Zotit si dhe në shërbim ndaj të afërmit”. Të gjithë ishin dakord që ta praninin këtë sugjerim të shndritur nga Shpirti i Shenjtë. Por themeluesi shtoi “të Shën Palit” duke e vënë si model për jetën tonë me një jetë aktive në

apostullat siç ishte apostulli i madh Shën Pali.

Motrat Engjëllore të Shën Palit çdo ditë rriteshin në numër dhe pas një përgatitje të duhur u përhapen në apostullat dhe vepërimtari të ndryshme dhe kështu ishin një ndër Kongregatat e para me jetën aktive në Kishë. Edhe pas vdekjes së themeluesit Motrat Engjëllore krahas Etërve Barnabit dhe Laikëve të Shën Palit vazhdonin zellin e tyre në misionin ndaj popullit, në formime të shoqërive, në mbikëqyrjen e të sëmurëve, në formimin e Manastireve. Kështu Motrat Engjëllore vepronin vazhdimisht ku ishte nevoja deri në vitin 1552 ku pa dëshirën e tyre u qe urdhëruar që të hynë në klauzurë (jetë e mbyllur).

Gjatë kësaj kohe stimë të madhe kanë pasur nga Shën Karlo Borromeo Arqipeshkv i Milanos, ai thoshte “Engjëlloret janë gurtë e çmueshëm të mitrës time”.

Me 1810, në kohën e Napoleonit të gjitha rregulltarët i mbyllën në Manastirin e Shën Mauricit në Milano me urdhër që të mos praninin më postulate, thirrje të reja. Kështu që Kongregata u Konsumua (vdisnin Motrat).

Me 1846, vdes po në atë manastir Engjëllorja e fundit Maria Tereza Trroti Bentivoglio, e cila para se të ndërronte jetë bashkoj të gjitha dokumentet më të rëndësishëm të Kongregates dhe ja dorëzoi njërit prej Etërve Barnabit Atë Spirito Corti.

Me këtë dukej se Kongregata e Motrave Engjëllore të Shën Palit u shua për gjithmonë.

Rilindja e Kongregates

Por Zoti ka rrugët e tija të shumta dhe të ndryshme. Në planin e tij të Provanisë Hyjnore nuk dëshiron humbjen e një familje rregulltare aq të lashtë dhe të meritueshme.

Mbas 33 viteve, rreth vitit 1879, ndërsa rritej gjithnjë e më tepër interesimi dhe devotshmëria e të Lumturit Shën Anton Maria Zakaria, të cilin Etërit Barnabit përgatitshin Kanunizimin e Shenjtërimin të tij, që do të jetë me 27-05-1897. Hyji shndriti Atë Piu Maurin që të rilind Kongregatene e Motrave Engjëllore.

Dy vajza po të njëjtit qytet (Kremonë) të themeluesit tonë u ofruan për Rilindjen e Kongregatës.

Prova të mëdha karakterizoj-

nit të Kongregatës së ore të Shën Palit



në fillimin e rithemelimit, vuajtja viziton shumë shpejt bashkësinë e posa lindur me sëmundjen dhe vdekjen e njëres nga dy Motrat Engjëlllore, tjetra Motër donte të tërhiqej nga frika që vetëm nuk mund të bënte asgjë për të vazhduar jetën e Kongregatës, por me rastin e shkuarjes së Mons. Gelmini në varrim, në predikimin e tij theksoj duke inkurajuar Motrën me këto fjalë “Sot themelohet Kongregata e juaj sepse e keni një pajtorë në qiell”.

Në të vërtetë për një kohë të shkurtër disa vajza të reja kërkonin që të hynin për të bërë pjesë në Kongregatën e Motrat Engjëlllore të Shën Palit duke jetuar dhe vepruar sipas jetës në kllauzur.

Për një periudhë shumë të shkurtër u hapen tri Manastire të kësaj Kongregate: në Milano; në Fivizzano dhe në Arienzo. Këto tri Manastire, që në fillim kishin jetë klastrale së shpejti u hapen dyert sipas nevojave të shoqërisë të asaj epoke. Pasi pushoj Lufta e Parë Botërore 1915-1918, filluan nevoja të reja të asaj kohe dhe motrat Engjëlllore ishin çdo kund të pranishme për të lehtësuar vuajtjet e mëdha fizike dhe morale të njerëzve.

Motër Gjovana Maria Brakaval tani Shërbëto e Zotit duke dëshiruar të mirën e bashkësisë së saj e të shpirttrave, me lejen

e superiorëve të klerit e të etërve Barnabit hyri në punë që manastiri i saj të shndërrohet në një Kongregatë që ti kushtohet apostullatit të lirë kështu që të lirohet nga obligimi i kllauzurës e të kthehem si më par siç dëshiroi themeluesi jonë për të cilin veprim na themeloi.

Motrat Engjëlllore, duke mbetur besnike ndaj motos së Atit tonë shpirtëror, i cili u tha motrave të para: “Bija të dashura, shpalosni flamujt tuaj... sepse së shpejti i kryqëzuari do t’ju dërgojë të shpallni gjallërinë shpirtërore dhe shpirtin e gjallë në mbarë botën”, e kështu karizma e jonë u përhap në shumë vende të ndryshme nëpër botë si në Itali, Brazil, Kongo, Spanjë, Kili, Portugali, Belgjikë, SH.B.A, Filipine, Shqipëri, Poloni, Afrikë, Indonezi, si dhe këtu në Kosovë ku edhe i shërbejmë Kishës duke zhvilluar aktivitete të ndryshme si në: çerdhe, kopshte, shkolla fillore deri në arsimin e lartë të drejtimeve të ndryshme, katekizëm dhe asistencë të moshuarve, vizita nëpër familje etj.

Kemi parë dhe vazhdojmë të shohim qartë se është vullnesa e Zotit që edhe në Kosovë t’i shpalosim flamujt tonë, jemi të pranishme që nga viti 1976 në famullinë e Prizrenit.

Fillim të ri të bashkësisë së parë në Prizren i dhanë dy Mo-

tra italiane Motër Gemma Nacarato e Motër Grazia Muzzi, të cilat për ta kryer vullnesën e Zotit lanë çdo gjë, edhe atdheun e tyre për të punuar për vendin tonë ku e themeluan bashkësinë e parë. Fillimi ishte shumë i vështir për shkak të gjuhës, kulturës dhe traditave të

reja. Por përmes sakrificave të tyre dhe flijimit të jetës së tyre dhe së shpejti Zoti i bekoj me thirrje të reja, ku patën një përgatitje të duhur dhe që nga fillimi jemi munduar të jetojmë sipas karizmës tonë; duke shpallur “Misterin e Krishtit të kryqëzuar dhe të gjallë në Eukaristi” duke dëshmuar me përvujtëri dhe zell fenë në Të, dhe dashurinë për të afërmin: në punën Baritore të Ipeshkvisë, të Seminarit dhe të famullisë së Prizrenit, duke bërë katekizëm, udhëheqjen e korit dhe në veprimtari të ndryshme shoqërore. Gjithashtu puna jonë është zhvilluar pranë spitalit duke u kujdesur për të sëmurët dhe së fundi veprimtaria jonë zhvillohet edhe nëpër shkolla për edukimin e fëmijëve dhe të rriturve.

Duke pasur parasysh karizmin, bashkësia jonë ndjente një nevojë të madhe që të ndërtojë të ardhmen duke u nisur prej fëmijëve që janë shpresa dhe jeta e një shoqërie.

Inaugurimi i kopshtit, ku punojnë dhe veprojnë motrat tona, u bë ditën e “Zotës së Këshilli të Mirë” më 26.4.2002. Kopshtin e udhëheqim ne motrat Engjëlllore, ku me një dashuri të madhe i përkushtohemi në tërësi këtij misioni të ri, sepse kopshti është hallka e parë e sistemit jetësor dhe arsimor ku në qendër të veprimtarisë është fëmija. Të ar-

riturat e fëmijëve gjatë edukatës që marrin në kopsht, realizohen në punën e zhvilluar përmes aktiviteteve të shumta dhe të ndryshme. E gjithë kjo punë kërkon vërtet shumë durim, sakrificë por me ndihmën e Zotit dhe të Provanisë Hyjnore arrijmë që t’iu ndihmojmë fëmijëve tanë kosovar në edukimi dhe rritjen e tyre integrale. Aktualisht numri i fëmijëve të regjistruar për vitin 2009/2010 është gjithsej 90 fëmijë.

Të punosh në kopsht me fëmijë kërkon: kohë, dashuri, flajm... dhe si shpërblim të kësaj kemi: kënaqësinë, gëzimin dhe lumturinë.

Kopshti gjithashtu u ndihmon fëmijëve të jenë të lumtur, të aftë për t’i përballuar sfidat e jetës.

Në shtator të vitit 2009, duke iu përgjigjur nevojave të Kishës, kemi hapur bashkësinë e re në Prishtinë në kuadër të Ipeshkëvisë. Aty motrat kryejnë shërbimet e ndryshme sipas nevojës së kërkuar.

Lusim Zotin që ta bekoj Kongregatën tonë me thirrje të reja, gjithashtu ta bekojë misionin tonë gjatë veprimtarisë së përditshme në mënyrë që të krijojmë mundësi ta realizojmë vullnesën e Zotit dhe ta shenjtërojmë jetën tonë dhe të afërmin tonë.





Intervistë me Jusuf Buxhovin

Figurat e ndritshme shqiptare: inspirim për një kulturë të shëndoshë

Rugova ka qenë një karakter tipik i gjeneratave të intelektualëve të atyre viteve, të cilët kanë kërkuar të lirohen prej të gjitha kthetrave të dogmave ideologjike dhe të lidhemi me qytetërimin perëndimor. Nuk i takojmë Lindjes, ne i takojmë Perëndimit, dhe asnjë argument nuk flet se shqiptarët kanë diçka të përbashkët me një mentalitet të tillë lindor.

Drita: Ku është kultura e shqiptarëve sot, sa po i jepet rëndësi asaj?

Buxhovi: Të flasësh për kulturën, duhet disa gjëra t'i diferencosh, sepse kultura ka kuptimin e gjërave, ka kuptim shumë të gjerë. Ne mund të flasim për kulturën, si një prodhim aktual shpirtëror, i cili duhet të jetë një kompetencë e shtetit, meqenëse ne e kemi shtetin. Për këtë të dytën, megjithatë, mund të thuhet që nuk është në nivelin e duhur, sepse shteti nuk po sillet në përputhje me përgjegjësinë që ka si shtet. Nuk përputhet me përgjegjësinë të cilën objektivistisht njerëzit e kulturës ia kanë projektuar këtij shteti. Sepse shtetin e Kosovës e kanë projektuar njerëzit e kulturës. Ata kanë punuar për të, sepse ajo ka qenë edhe projekt kulturor intelektual. Dihet mirë, mos ta quaj ngritje, në vitet e '80-ta '90-ta roli i intelektualëve, por pas gjithë kësaj që ka ndodhur, mund të them me keqardhje, se kultura ka mbetur mbrapa dhe është zhvlerësuar edhe në një farë mënyre, është e zhvlersuar, sepse nuk po sillemi me fundamentin që e kërkon. Një shoqëri e cila pa kulturë nuk mund të ketë as të tashmen politike e as të ardhmen shoqërore, dhe ky është një problem i madh, i cili mund të flitet shumë më shumë në këto pika të përgjithshme. Mund të thuhet se shteti i Kosovës nuk sillet në përputhje me misionin që ka.

Drita: Në aspektin më të gjerë, si shqiptarë, duke e përfshirë edhe Shqipërinë?

Buxhovi: Të them të drejtën, këtu ka probleme të mëdha, sepse edhe ne edhe Shqipëria kemi jetuar të ndarë. Kemi jetuar në rrethana të caktuara ndoshta ideologjikisht të njëjta, por me praktika të ndryshme, sepse në Shqipëri ka qenë një stalinizëm shumë i rëndë, një diktaturë, ndërkohë që në Kosovë në vitet e '70-ta, '80-ta ka ekzistuar njëfarë liberalizmi, njëfarë pluralizmi kulturor, ku shqiptarët kanë pasë mundësinë të ikën prej atyre dogmave dhe të krijojnë interesin e tyre brenda përbrenda, të forco-

jnë identitetin e tyre brenda atyre kornizave. Dhe të them të drejtën, mbas rënies së murit shqiptar, kemi pa se ekzistojnë probleme shumë të thella, dhe në disa momente të papërballueshme, edhe në plane shpirtërore. Këtu është një gjendje shumë e rëndë, sepse thuajse kemi dy pole, kemi një gjendje kaotike. Në Shqipëri ku nuk ekziston kultura fare, por ekzistojnë prirjet për tranzicion të një shoqërie, e cila sillet jashtë normave civilizuese dhe jashtë normave intelektuale. Madje, ndërsa tani kemi po ashtu një gjendje, kur një klasë politike harron, ashtu nuk dëshiron të merret me kulturë, sepse duket se ashtu e ka më lehtë që t'i realizojë disa aspirata të veta politike. Më nuk është çështje si ka qenë përpara. Përpara ka qenë ideal dhe është punuar për të, ndërsa tani më nuk është ideal, nuk është bile as çështje pragmatike, e cila do të duhej që të ishte. Kultura kombëtare nuk ka kuptim as të planit shkollor, që së paku do të duhej të ishte, edhe pse në nivel të Bashkimit Evropian, në nivel të atyre që quhen integritime, ekzistojnë disa konsensus të bërthamave kulturore intelektuale. Tek ne nuk ekzistojnë dhe është një problem i madh. Së pari duhet të bëhet një sqarim me trashëgiminë ideologjike, veçmas në Shqipëri.

Drita: Kadareja?

Buxhovi: Kadareja po ashtu është pjesë e një të kaluarë ideologjike, i cili ndryshon prej të tjerëve, sepse megjithatë ai me veprën e tij krahas atyre që i ka bërë, që kanë qenë në kontekstin e propagandës ideologjike, ka bërë përpjeke që të dalë nga kjo. Kadareja nuk është shkrimtar tipik 100% i realizmit, ka vepra të tij që kanë dalë prej atij konteksti. Është punë e mirë që kanë dalë, por është problem shpjegimi që Kadareja mundohet t'ua bëjë dhe diskutet që ai ia ngrit veprës së tij, gjoja si disident, që nuk është e vërtetë, dhe këto mandej barten tek shoqëria në përgjithësi, tek shoqëria shqiptare, në vend se të qërojnë hesapet me socializmin më së pari, si një damkë e rëndë

e shoqërisë shqiptare. Dhe këtu mandej dalin probleme që ne, pa i sqaruar këto gjëra, nuk mund të bëjmë as edhe një letërsi shqiptare të përbashkët, e as historinë nuk mund ta trajtojmë si duhet, sepse gjithmonë na ndjek ideologjia, na ndjekin kundrimet e të kaluarës. Domethënë, janë disa shema, të cilat është vështirë të rrënohen nga shkak i interesave, edhe kjo është një detyrë dhe një problem i madh i shoqërisë shqiptare; domethënë, këtë tranzicion politik, në të cilin, në forma të ndryshme, po ecet përpara, qoftë me probleme apo pa to. Ndërsa në planin shpirtëror dhe intelektual nuk po ecet përpara. Ne po ngecim edhe në çështjet më fundamentale. Ne sot jo vetëm që nuk kemi gjuhë të përbashkët, por ajo edhe nuk ushtrohet fare. Do të thotë, janë disa probleme, problemet e vlerësimit historik të historisë, problemet e vlerësimit historik të letërsisë, dhe problemet e vlerësimit të kulturës në përgjithësi, duke përfshirë edhe gjuhën. Sepse ne kemi edhe probleme të gjuhës. Gjuha për shembull, e ka një normë të vetën, e cila është arritë në vitet e '70-ta. Atëherë ishte një arritje e madhe, por kjo nuk do të thotë që sot nuk duhet të matet, të shqyrtohen gjërat, sepse çdo gjuhë është mekanizëm i gjallë. Do të thotë ajo ka nevojë për plotësim, ka nevojë për riformim. Atë e bëjnë të gjithë popujt e botës.

Drita: Këtu në Kosovë ka tendenca të ringjallet një gegnishte e bastardhuar?

Buxhovi: Ky është një gabim i madh, por të them të drejtën këtu ne nuk duhet fajësuar tendencat e tilla që dalin, duhet fajësuar kompetencën intelektuale dhe sociale të një populli, të një shoqërie e të një shteti. Gjërat e tilla do t'i ndërpresim, nëse do të kishte tek ne një program që shteti i Kosovës dhe institucionet e tjera, akademia, universiteti e tjerë, të trajtojnë gjuhën në përputhje me zhvillimin shoqëror, kulturor dhe ekonomik të shqiptarëve. Kjo çështje duhet të shikohet me kompetencë të madhe, të shikohet se çfarë mund

të bëhet që gjuha shqipe ta kthejë fundamentin e saj. Në fund dallimet janë kreative, nuk duhet këtu shumë mend, por vetëm që t'i kthehemi komisionit letrarë të 1908-1909-1910, ku ka qenë kryetari i saj Atë Gjergj Fishta, ku kanë qenë po ashtu intelektualë të rëndësishëm të letërsisë e të Rilindjes kombëtare, të cilët edhe e kanë përcaktuar konceptin politik, dhe aty do të shohim çfarë ka qenë ajo platforma shumë e dobishme edhe sot. Unë besoj se me pak punë, me më shumë përkushtim profesional, shqiptarët do ta kishin një gjuhë kombëtare të përbashkët, me një platformë shumë të natyrishtme të gjuhës shqipe. Do të thotë që mungojnë nismat në këtë drejtim, dhe mendoj që ky është një gabim i madh që edhe Akademia e Shkencave të Kosovës, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, por edhe shqiptarët e Maqedonisë, duhet të mblidhemi dhe të arrijmë një pajtim. Por problemi më i madh është se tash janë cimentuar këto. Dikush thotë, se kjo nuk duhet të preket, se po preket bashkimi kombëtar. Bashkimi kombëtar lëndohet dhe bëhet më i paqëndrueshëm, pikërisht nëse dikush mundohet ta mbrojë diçka që objektivistisht i takon një zhvillimi, dhe gjuha shqipe i takon një zhvillimi kulturor e shpirtëror. Nuk mund të ketë tabu. Gjermanët kanë bërë para dy tri viteve normën, e kanë rishikuar pesë vjet dhe kanë punuar bashkërisht tri shtete që e kanë konventën: Gjermania, Zvicra dhe Austria, dhe kurrfarë tërmeti në Gjermani nuk është bërë, pse është bërë një rishikim i asaj norme.

Tek ne duhet të bëhet rishikimi i historisë, rishikimi i historisë së letërsisë dhe trajtimi i saj në përputhje me zhvillimin e nevojave të reja, dhe rishikimi i gjuhës. Këto janë tri gjërat, të cilat shqiptarët i bashkojnë shpirtërisht. Nëse ne këtu sillemi si po sillemi deri tash, mund të themi se jemi edhe më të varfër, jemi edhe më të ndarë, e jemi edhe më të lëndueshëm nga aspekti politik dhe shoqëror.

Drita: Ju jeni ndër nismëtarët dhe themeluesit e Lidhjes Demokratike në atë kohë. Lidhja Demokratike gjithmonë identifikohet me figurën e Rugovës. Mua më intereson figura e Rugovës në sytë e Jusuf Buxhovit.

Buxhovi: Kam thënë disa herë e veçmazi në trilogjinë time, në librin e parë dhe në librin e dytë. Ibrahim Rugova mbetet një ndër figurat më të rëndësishme politike dhe kulturore të popullit shqiptar në përgjithësi të shekullit 20-të. Këtë e them me bindje të plotë, me argument të plotë, ai po ashtu mbetet edhe njeriu më i rëndësishëm i lëvizjes së shtetformimit të Kosovës. Roli i tij është i padiskutueshëm. Historia mundet në një farë mënyre ta rishqyrtojë apo ta kundrojë nga shumë aspekte, por assesi nuk mundet ta heqë nga panteoni, të cilin ai e ka. Do të thotë se Rugova ka luajtur rol të jashtëzakonshëm në proceset politike, të cilat kanë arritur deri të formimi i shtetit të Kosoves. Por Rugova pa gjeneratën, e cila ka qenë e pjekur në ndryshime të tilla, nuk do të ishte ai që ka qenë. Po ashtu edhe shteti i Kosovës nuk do të ishte ai që është sot. Dhe kjo gjithsesi lidhet me një kulturë shtetformuese, me një proces historik, i cili në vitet e 70-ta e 80-ta u vu në lëvizje, sepse ishte një kapërcim i gjeneratave dhe i kërkesave, në vitet e 60-ta, siç dihet i kemi edhe ndryshimet e mëdha në Jugosllavi, pas rrëzimit të Rankoviçit etj. Ato sollën rishikimin e strukturës së shtetit jugosllav, do të thotë se aty u pa se ka dy lëvizje, një lëvizje unitariste që Serbia zakonisht e vazhonte dhe një lëvizje që kërkonte barazinë e shqiptarëve me të tjerët në Jugosllavi. Kjo e dyta fitoi, do të thotë në Kushtetutën e 74-ës, autonomia e Kosovës u ngrit në nivelin konstitutiv, në faktorin konstitutiv të Federatës jugosllave. Kjo ka qenë shumë e rëndësishme, aty gjenerata e intelektualëve shqiptarë, dhe të rinjëve kosovarë do të përcaktohen për barazi, kjo është ajo që mund të thuhet se e ka identifikuar gjen-

eratën e Rugovës. Kjo është ajo kthesa më e madhe në vitet e 60-ta e 70-ta e më vonë, ku kërkohej që Kosova të jetë republikë. Situata ishte e ngjashme me atë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Këtë gjendje Rugova e ka udhëhequr me mençuri jashtëzakonisht të madhe, dhe po e përmendi prapë se është njëri ndër personalitetet më të rëndësishme të historisë së shtetit të Kosovës.

Rugova ka qenë një karakter tipik i gjeneratave të intelektualëve të atyre viteve, të cilët kanë kërkuar të lirohen prej të gjitha kthetrave të dogmave ideologjike dhe të lidhemi me qytetërimin perëndimor. Domethënë Rugova dhe një pjesë e madhe e intelektualëve të asaj kohe, po flas për shkrimtarët, kanë kërkuar pikërisht ndërlidhjen e shqiptareve me Perëndimin nëpërmes lashtësisë historike të krijimit të antikave, d.m.th jo rastësisht Rugova ka doktoruar tek veprat e Bogdanit, jo rastësisht unë i kam shkruar “Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit”, jo rastësisht Mehmet Kraja ka shkruar një roman për “Motin e madh”, për kontekstet e shpërnguljes kombëtare mbas vdekjes së Skënderbeut, jo rastësisht Mehmet Kraja e ka bërë edhe një roman tjetër “Udhëzime për kapërcimin e detit”, ku lidhet me referencën e vitit 1333, kur Brokardi thotë se shqiptarët flasin një gjuhë tjetër, d.m.th edhe veprat tjera të gjitha janë të kësaj natyre deri edhe tek ajo e Sabri Hamitit për trungun ilir. Është një gjeneratë, e cila kërkon identitetin e vërtetë kulturor. Rugova ka qenë një përfaqësues i drejtpërdrejtë i kësaj gjenerate. Në këtë drejtim si njeri dhe si intelektual ka qenë i pajisur me një kulturë evropiane, sepse është identifikuar me atë kulturë.

Lëvizja jonë nuk do të ishte kjo që është sot, pa atë ne nuk do të arrinim të japim dëshmitë më të fuqishme Perëndimit, se jemi një popull, i cili ka një preokupim intelektual dhe shpirtëror e politik me përkatësinë perëndimore. Ky ishte një veprim vendimtar. Unë vazhdimisht merrem me këtë problem. Te Trilogjia ime, veçmas tek kjo e fundit, tregohet kontinuiteti historik i shoqërisë shqiptare si shoqëri, fundament i antikës. Kjo nuk është një dëshirë e jona që është projektuar, pse ne duam të jemi nga Përendimi, por pikërisht ne me të drejtë kemi kërkuar që t'i kthehemi historisë sonë, e cila është histori e antikës, sepse qytetërimi antik në atë tërësi merret me historinë e shqiptarëve prej pellazgëve e deri tek ilirët. Sot shumë hulumtime çojnë në ato drejtime, se shqiptarët kanë paraqitë fundamentin e kulturës antike para grekëve, dhe se në këtë drejtim duhet të punohet dhe kjo që na takon neve, pa i minimizuar të tjerët, por ta tregojmë hisen tonë dhe në këtë drejtim edhe Rugova edhe gjenerata e intelektualëve ka bërë një kapërcim jashtëzakonisht të madh. Prapë duhet të kthehemi tek kjo, se ajo që sot na mungon neve, pikërisht në kulturë, është se ne e harrojmë këtë interferencë

që e kemi, që lidhet me kulturën tonë dhe me lashtësinë antike dhe kërkojmë koniunktura të tjera dhe mandej mbesim të papërcaktuar. Rruga që është ndjekë në vitet e '90-ta me Rugovën dhe me klasën politike, është edhe një udhërrëfyes shpirtëror dhe politik i popullit shqiptar drejtë Perëndimit.

Drita: Askush më mirë nuk e ka shndrit figurën e Gjon Nikollë Kazazit se sa ju. Jusuf Buxhovi e ka parë me shpirtin e vet atë. Njerëzit që nuk i kanë lexuar “Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit”, si duhet ta njohin atë?

Buxhovi: Gjon Nikollë Kazazin unë në veprën time, por jo vetëm Gjon Nikollë Kazazin, e kam shikuar në aspektin kulturor. Gjon Nikollë Kazazi për mua si gjithë intelektualët e tjerë, Buzuku, Bogdani, Budi janë pjesë e një kulture shpirtërore shqiptare, ata kanë vepruar si intelektualë në rrethana të caktuara dhe kanë arritur kulmin e tyre (dhe rrethanat kanë qenë në atë kohë çfarë kanë qenë). Për mua ka qenë inspirative figura e Gjon Nikollë Kazazit, po jo vetëm e tij si intelektual, i cili në rrethana të caktuara vihet në krye të një procesi kulturor emancipues dhe historik. Në fund të fundit dhe këtu është ajo domethënia, intelektualëve u bie barra që janë në çdo situatë kritike, ta marrin për sipër një rol. Kazazi është referenca e këtyre të dyjave. Gjon Nikollë Kazazi jo rastësisht është një ndër ata që e ka zbuluar Mesharin e Buzukut në Vatikan. Një vepër, e cila dyqind e sa vjet ka qenë e heshtur. Dhe s'do të dinim për atë po mos të ishte Gjon Nikollë Kazazi.

Gjon Nikollë Kazazi po ashtu si intelektual është nga Gjakova, kjo po ashtu tregon jo vetëm për një ambient gjeografik, po edhe diçka më thellë. Kazazi për mua është një figurë e rëndësishme në një moment që ta përfytyrojmë letërsinë në mënyrën time dhe ta fuqizojë atë.

Drita: Ju jeni marrë mjaft me Kongresin e Berlinit, keni hulumtuar. Ku ka qenë problemi në atë kohë që çështja shqiptare nuk është marrë në dorë si duhet nga ky kongres?

Buxhovi: Nuk është që nuk është marrë në dorë çështja shqiptare. Çështja shqiptare është trajtuar në mënyrë të veçantë. Problemi është se ne shumë pak i kemi njohur dokumentet origjinale, andaj edhe janë interpretuar në mënyrë të gabueshme. Shpesh herë qëllimisht na janë servuar në këtë mënyrë. Nga interpretimi i gabuar është krijuar bindja se Evropa ka qenë kundër shqiptarëve edhe se shqiptarët i kanë injoruar në Kongresin e Berlinit. Kjo nuk është e vërtetë. Shqiptarët në Kongres janë trajtuar për sa ata kanë kërkuar. Në këto dokumente tregohet se Lidhja Shqiptare e Prizrenit ka pasur kërkesa për autonomi mbrenda Perandorisë Osmane. Shqiptarët nuk kanë kërkuar që të ndahen nga kjo pe-

randori. Kërkesa e tyre ka qenë për autonomi. Neni 23 i traktatit të Kongresit e obligon Perandorinë Osmane që të rregullojë, të shikojë kërkesat e popujve të perandorisë në përputhje me reformat për autonomi. Kjo do të thotë se neni 23 e parasheh edhe ato që do të ndodhin në vitin 1908-1911, dhe kërkesat që të shtrohen nga Ismail Qemali në gazetën italiane *Il popolo*, do të lidhen pikërisht me pikën 23 të Traktatit të Berlinit, ku kërkohej reformat e Perandorisë Osmane. Këtu është moskuptimi i parë, dhe nëse një popull bën një kërkesë ku kërkohej autonomia, të gjitha dokumentet e Kongresit Perandoria Osmane është detyruar që t'i zbatojë ato reforma. Mbetet çështja e interpretimit, siç janë problemet që janë shkaktuar për shkak të disa territoreve që iu kanë marrë shqiptarëve, fillimisht Plava, Gucia pastaj Hoti, Gruda deri te Ulqini në jug. Por plani në përgjithësi, mund ta them me kompetencë, Kongresi i Berlinit nuk ka qenë antishqiptar. Evropa nuk ka qenë antishqiptare. Gjermanët nuk kanë qenë antishqiptarë. Bismarku nuk ishte kundër shqiptarëve. Përkundër me insisti-

dhe e ka sjellë një realitet tjetër, i ka sjellë katër vilajetet shqiptare, i ka rikthyer në Perandorinë Osmane, dy prej tyre veç kanë qenë të copëtuara 34 vjet. Tashmë shqiptarëve u është lënë shansi për t'i realizuar aspiratat e tyre politike, ashtu siç i ka realizuar. Dhe po e them prapë, po të mos ishin ato fuqi të mëdha, Austro-Hungaria, Gjermania dhe Anglia, Shqipëria nuk do të ekzistonte. Sepse ne e dimë edhe si është shpallur pavarësia e shqiptarëve, kur realitetet, kur shqiptarët kanë qenë të pushtuar prej katër ushtrive ballkanike, dhe Vlora ka qenë 2km katrorë, pa komunikim me botën. Por ato fuqi evropiane e kanë njohur pavarësinë e Shqipërisë. Po të mos ishin Evropa (që ne e quajmë jo k...ë, e me emra të tjerë), s'do të ekzistonte Shqipëria. Ju flas jo vetëm si një historian, por edhe si një intelektual, për të treguar se nuk është e vërtetë ajo patetikja historike, se Evropa na mori në qafë, Evropa na copëtoi. Përkundrazi, Kongresi i Berlinit u ka ofruar shansin historik shqiptarëve që ta arrijnë pavarësinë kombëtare. Dhe këta e kanë arritur me ndihmën e vendeve evropiane, po e them në mënyrë decitive, pa të nuk do kishim as intervenimin e NATO-s në vitin 1999.

Drita: Mos ka qenë ndoshta problematika që shqiptarët kanë kërkuar pak në Kongresin e Berlinit?

Buxhovi: Jo, nuk kanë kërkuar pak. Shqiptarët kanë kërkuar, bile-bile është njëri ndër konceptet më të pjekura politike i shqiptarëve, pavarësisht se ajo nuk është thënë në disa mënyra, ndoshta si duhet, në kuptimin e një diplomacie. Por të kërkohej autonomi, katër vilajete të bashkohen, ajo ka qenë maksimumi, sepse autonomia është ditur që do të ngrihej në pavarësinë e shtetit. Nëpërmes autonomisë në Ballkan të gjitha shtetet kanë fituar pavarësinë. E kemi shembullin edhe të Serbisë, edhe të Bullgarisë e të Greqisë, edhe Rumanisë. Të gjitha kanë kaluar nëpër faza të autonomisë. Ka qenë fazë kallimtare. Shqiptarët kanë kërkuar autonominë në mënyrë që të mbrohen prej copëtimeve. Pikërisht Lufta e parë ballkanike lidhet me çështjen e shqiptarëve dhe me copëtimin e tokave shqiptare.

Të mos harrojmë edhe këtë fakt, Anglia në vitin 1880 në Konferencën e Ambasadorëve në Stamboll kërkon që shqiptarët të jenë një digë kundër depërtimit të sllavëve në Ballkan.

Drita: Shqiptarët ku e kanë vendin, tashti është një tendencë e ministrit të punëve të jashtme të Turqisë, që shqiptarët edhe territoret që ishin nën Perandorinë otomane në atë kohë, Bosnja dhe Sanxhaku të jenë pjesë shpirtërore e saj. Ne në anën tjetër pretendojmë se jemi pjesë e Evropës, kah duhet të shkojnë shqiptarët, a është

rrezik i ndonjë talibanizmi i shqiptarëve?

Buxhovi: Ato që i kërkon Turqia nuk janë kërkesa, ato më shumë janë politikë... Më së paku Turqia sot po shikohet në kontekstin e civilizimeve, në pronat e osmanizmit. Kanë qenë shqiptarët, të cilët Perandorinë osmane e kanë ndarë nga islamizmi fanatik. Do të thotë, Turqia sot është një shtet sekular, një nga shtetet më sekulare, nuk është më rreziku i atij problemi politik. Por ekziston një rrezik tjetër, rreziku që në forma të ndryshme shqiptarët t'i nënshtrohen koniunkturave në mes të Lindjes dhe Perëndimit, t'u nënshtrohen pikërisht këtyre nënvijimeve që janë të tejkaluara, se a jemi pjesë e kësaj apo pjesë e asaj. Ne jemi pjesë e Perëndimit, nuk kemi çka të diskutojmë. Pra, të gjitha dëshmitë civilizuese tonat janë në atë drejtim. Nëse dikush dëshiron për ta megjulluar këtë, është vetëm një gabim, i cili mund të na çojë tek natyra e një kulture politike të paqëndrueshme. Ne e kemi rolin në Evropë, nuk kemi se çka të diskutojmë. Rilindja kombëtare shërbimin më të madh intelektual dhe politik që ua ka bërë shqiptarëve dhe botës tonë, është se e ka caktuar shumë në mënyrë të qartë, shqiptarët e kanë vendin në Perëndim. Feja e shqiptarit është shqiptaria, jo në kuptimin e zhvlerësimit të religjionit, por në kuptimin e një rëndësie të një formule politike e shoqërore të shqiptarëve. Shqiptaria si koncept patriotik, shqiptarët i identifikon si popull perëndimor, çdo gjë që sot flitet jashtë këtij koncepti, është prapanik dhe çon në dëm të shqiptarëve, çon pikërisht në ujë tek tezat shoviniste të serbëve dhe ide të nacionaliste greke. Do të bënim gabimin më të madh poqese ne do të ishim në dyshim se ne shpirtërisht i takojmë Lindjes. Nuk i takojmë Lindjes, ne i takojmë Perëndimit, dhe asnjë argument nuk flet se shqiptarët kanë diçka të përbashkët me një mentalitet të tillë lindor. Ne jemi perëndimorë, dhe këtë e kemi arritur me mund të madh. Kongresi i alfabetit më 1908, alfabeti latin këtë dilemë e ka hequr përgjithmonë. Krejt luftërat që janë bërë nga 1908 deri tek 1912 e ka pasur edhe këtë aspekt, që bile-bile edhe është kushtëzuar politikisht, po qe se shqiptarët do të merrnin alfabetin arab, siç kanë qenë kërkesat nga sultan Hamiti, por edhe i xhonturqve, atëherë me siguri që edhe konfigurimi politik ndoshta do të mund të ishte tjetër. Por ai do të mund të ishte i rrezikshëm, sepse ai do të mund të ishte një efekt i caktuar politik, për nevojën të caktuar politike dhe sakrifikisht do t'i rrëronte shqiptarët. Por edhe askush në Evropë nuk do të lejonte një mini-perandori osmane. Çdo gjë që përkujton me këtë ide, është shumë e rrezikshme tek shqiptarët. Nuk kemi nevojë fare të kapemi me gjëra që moti janë zgjidhur.

Patër Ndue Kajtazi



min e Bismarkut, por me propozimin e kryesuesit të delegacionit anglez, (anglezët kanë pasur një qëllim parimor në këtë drejtim), dy herë në dokumentet e Berlinit thonë se territoret shqiptare nuk duhet t'u lihen sllavëve, sepse sllavët janë barbarë. Ne nuk i kemi njohur këto dokumente, dhe janë marrë gabimisht nga interpretimi i historiografisë serbe, e cila i ka pasë arsyet e veta t'i armiqësojë shqiptarët me Evropën, dhe në të njëjten kohë t'i realizojë aspiratat e veta. Këtu desha të them, edhe një fakt tjetër, (si historian po ju flas), vetëm Kongresi i Berlinit dhe insistimi i Bismarkut dhe i anglezëve të mos qëndrojnë realiteti i Shën Stefanit. Me Shën Stefanin do ta kishim Rusinë, Bullgarinë e Madhe dhe një pjesë e mirë e vilajeteve shqiptare do të mbetej nën Bullgarinë e madhe. Dhe shtrohet pyetja, çka do të mund të bënin shqiptarët në ato rrethana po qe se në Ballkan do të ishte një stabilitim i zonës Ruse, i Bullgarisë së Madhe, e normalisht edhe i Greqisë dhe i Serbisë. Rasti i shqiptarëve, unë kujtoj se do të hiqej prej rendit të ditës. Kongresi i Berlinit e ka anuluar pagën e Shën Stefanit,

Stublla dje dhe sot

■ SHKRUAN:
Sarë GJERGJI

1. Autorë të shumtë, vendorë e të huaj, i janë qasur Stubllës nga anë e aspekte të ndryshme. Janë sidomos shkolla dhe martirizimi i popullatës së kësaj treve, pra dy shtylla kryesore të identitetit tonë kombëtar, të ruajtjes dhe progresit të tij, ato që në mënyrë të veçantë kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve të shumtë.

2. Stublla është një vendbanim, historia e të cilit, që nga shekulli i XV-të, falë të dhënave, argumenteve, fakteve të ndryshme, mund të përcillet në mënyrë kronologjike. Siç vëren, Dr. Rexhep Doçi, Stublla shfaqet në defterin osmano-turk të vitit 1455, po më këtë emër që ka sot, ndërkaq në vitin 1477 ajo do paraqitet në një hartë topografike të Shkupit. Në të vërtetë, në këtë hartë përmendet fshati Caravajkë në verilindje të Stubllës. Duke shërbyer kështu si një pikë orientimi, referimi për vendbanime të tjera, Stublla lë të kuptojmë se ishte një vend i njohur dhe jo pa rëndësi. Kështu, Stublla, do ketë komunikuar mirë me vendbanimet në rajon. Të përkujtojmë se afër varrezave të fshatit është udha e Kumanovës, (siç e quajnë banorët), një rrugë shumë e vjetër, e cila të shpie për në Kumanovë dhe që më të madhe është shfrytëzuar deri në vitet e '70 të shek. XX-të, kryesisht për tregti. Por, e kaluara më e hershme e kësaj rruge do jetë shfrytëzuar edhe për qëllime të tjera, pra jo vetëm për tregti, siç ka ndodhur së voni. E gjithë kjo të bën të mendosh për një zhvillim të mirë të Stubllës në të kaluarën, gjithmonë duke

pasur parasysh zhvillimet historike, rrethanat e kohës.

3. Të gjitha këto zhvillime do kenë krijuar, pse jo, edhe bazën e mirë për nevojën e hapjes së një shkolle. Siç thotë dr. J. Rexhepagiqi, shkollat janë hapur me iniciativën e priftërinjve, por shpesh edhe me kërkesën e popullsisë. Shkolla të këtilla ka pasur në fshatrat me popullatë më të madhe shqiptare dhe në viset në të cilat nuk shkonin shpesh turqit.

Kështu, që në shek. XVI, sipas këtij studiuesi, misionarët katolikë provuan të themelojnë një shkollë të lartë në territorin e famullisë katolike të Karadakut të Shkupit (Montenegro di Skopia). Në raportin e vizitatorit apostolik A. Komulloviqit, dhe shoqëruesit të tij T. Raggia, më 1584, rekomandohet hapja e një shkolle të këtillë "in forma di colegio" (në formë kolegjii) në territorin e famullisë së Letnicës. Hapja e kësaj shkolle arsyetohet nga fakti se "aty nuk banojnë dhe nuk vijnë turqit...". Sidomos Stublla (afër Gjilanit), fshat që flet gjuhën shqipe, ka qenë i përshtatshëm për hapjen e një kolegjii të këtillë katolik. Dh. Shuteriqi, thekson se kolegjii ishte një shkollë e lartë për kohën dhe se aty përveç teologjisë, mësohej filozofia dhe studioheshin klasikët. Bindjen tonë për ekzistimin dhe funksionimin e këtij kolegjii e sforcon edhe fakti i ekzistimit të një kishe madhështore kushtuar Shën Lukës, themelet e së cilës deri vonë kanë ekzistuar në varrezat e fshatit, ndërkaq që lëndina përbri quhet ara e kishës.

Jemi në shekullin e XVI-të, 29 vjet pas botimit të Mesharit, kur Perandoria Osmane mun-



Pamje nga Udhë e Kryqit

dohej të shkatërronte çdo gjë shqiptare, kur populli ynë mundahej me çdo kusht ta mbronte identitetin e vet, dhe kur Vatikani veç kishte filluar me reformat në kishën e saj, s'do mend se duhej të bëhej diçka, dhe kjo diçka është hapja e shkollave. Pozita gjeografike e Stubllës dhe konfiguracioni gjeografik i saj, e mbajnë Stubllën, si duket, ende larg syrit të Perandorisë Osmane. Nga ky kontekst mund të themi se Stublla ende nuk konsiderohej rrezik për Perandorinë, gjë që nuk do të ndodhë më vonë kështu. Veç kësaj, kjo Perandori po bënte gjithçka që ta thyente qëndresën shqiptare dhe përmes bregdetit shqiptar të lëvizte më lehtë në drejtim të Perëndimit.

Në fillim të shek. XVII e më vonë, historia e shkollës së Stubllës del në pah gjithnjë e më shumë. Kështu, J. Rexhepagiqi në një hartë ku paraqet shkollat shqipe në Jugosllavi dhe në Shqipëri, në shek. e XVII, bashkë me shkollat në Pejë, Glogjan, Gjakovë, Landovicë, Prizren, Poçest, Suharekë, Papaz e Janjevë e paraqet edhe shkollën e Stubllës. Hapjes dhe funksionimit të shkollave në këtë shekull, i ka kontribuar patjetër edhe angazhimi i Papës Gregorit XV. Ai urdhëroi (më 6.12.1622) që të gjithë peshkopët dhe kryepeshkopët në Turqi duhet të dinë gjuhën shqipe për një punë më të suksesshme politike dhe fetare.


Shek. i XVIII-të, për ne paraqet një boshllëk, në kuptim të dokumentimit të funksionimit të shkollës së Stubllës. Ne vetëm mund të supozojmë për funksionimin ose jo të kësaj shkolle, gjatë këtij shekulli. Do presim

vitin 1846 për të mësuar sërish për shkollën e Stubllës. Kështu na informon D. Mirëdita, në "Rilindja", Pr, 1-3 janar 1961, por edhe Radoshin Rajoviq në librin "Autonomia e Kosovës": "U hapen edhe dy shkolla në gjuhën shqipe: një në Stubëll (rrëzë Karadakut të Shkupit) u hap më 1846 dhe tjetra në Prizren, që u hap më 1889." Viti 1846 shënon një faqe të re në historinë tonë kombëtare: ju përkujtojmë internimin masiv për në Turqi, të popullatës së fshatrave të Karadakut, si të Stubllës, Binçës, Vërnakollës e Terziajve.

4. Jemi pra pak vite pas reformave të Tanzimatit, kur u dha e drejta e lirisë fetare, ndërkohë që liria e mësimin në gjuhën shqipe proklamohet vetëm formalisht. Pra, jo vetëm përkatësia etnike e fetare, që për kohën ishte e njëjta gjë, por edhe shkolla në gjuhën shqipe duhet të kenë qenë pafundësisht të papranuara për obskurantizmin Otoman. Edhe në Muhaliq, të internuarit do t'i luten famullitarit të tyre, Atë Anton Marojeviqit, që edhe këtu t'i mësojë fëmijët, por që nuk kishte mundësi për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore, si pasojë e torturave të shumta. Megjithatë mësojmë se mësimin për fëmijët tanë do ta mbajë një grek (ndoshta arvanitas, S.Gj.), me emrin Konsantin. Në anën tjetër, disa murgësia i morën disa fëmijë (Palin, Gjonin, Markun...) dhe i dërguan në Stamboll për shkollim. Pyesim se prej nga gjithë ky vullnet dhe dëshirë për shkollën edhe në mërgim... Internimi në vitin 1846 i kësaj popullate le të besosh se megjithatë shkolla do

ketë qenë hapur para këtij viti dhe jo në kohën e internimit. Sidoqoftë internimi lidhet sa për besimin aq edhe për shkollën, si dy shtylla themelore për ruajtjen e identitetit shpirtëror të tyre – në ruajtjen e identitetit kombëtar. Pse e themi këtë? Pranimi i islamizimit do të thoshte, asgjë tjetër, pos identifikimi me agresorin-turqit, ndërsa luftimi i shkollës shqipe dhe hapja e shkollës turke veç sa e ndihmon të parën. Por, është për t'u studiuar se pse nuk u internuan edhe kroatët e Letnicës, meqë edhe ata ishin katolikë?! Ndoshta për faktin se ata nuk kishin ndonjë ndikim në një ambient krejt shqiptar, pra ishin të parrezikshëm për politikën dhe aspiratat e Perandorisë...

5. Pas Lidhjes së Prizrenit, pra pas vitit 1878, hapen një numër i konsiderueshëm shkollash, si në: Prizren, Shkup, Manastir, Ohër, Zym, Gjakovë, Stubëll, Zllakuqan e gjetiu. Dr. Andrija Nikic, duke folur për hapjen e shkollave shqipe në Kosovë, në gjysmën e dytë të shek. XIX përmend edhe funksionimin e shkollës së Stubllës, që më 1888, shkollë kjo e ndihmuar nga Austro-Hungaria, bashkë me shkollën e Letnicës. Mësues ishte Bartolome Fantella, ndërkohë që pas largimit të tij, më 1891, sipas Nikiqit shkolla ndërpreu punën. Librat siguroheshin nga konsulata austro-hungareze në Shkup. Shkolla ka të ngjarë të jetë mbyllur për një kohë shumë të shkurtër, nga se, që më 1892, gjejmë shkrime të don Mikelit, të botuara në revistën Elcia e Zemrës së Krishtit, ku flet për punën e shkollës. Se shkolla



Pamje e Stubllës

Muzeu i Shkollës së Parë Shqipe në Kosovë



e Stubllës nuk ka pushuar së ekzistuari tregon edhe viti 1896. Në aktin themelues të famullisë së Stubllës, me 1 mars 1905, e cila më parë ishte filial e Letnicës, janë të nënshkruar, bashkë me don Mikelin, edhe Lush Gjergji (i lindur më 1889) e Gjon Gjergji (1892). Së paku Lushi do jetë nxënës i vitit 1896. Ekzistimin e shkollës së Stubllës në shek. XIX e pohon edhe J. Rexhepagiqi përmes hartës së shkollave shqipe në Jugosllavi dhe Shqipëri.

6. Të përmendet në vazhdimësi shkolla, që nga viti 1584, pra 130 vjet jetë të Stubllës si vendbanim (1455), në bazë të dokumenteve të gjetura, është vërtet një tregues i qartë që të bën ta pranosh ekzistimin dhe funksionim ndër shekuj të kësaj shkolle. Dhe jo vetëm kaq. Por, themi, se çfarë roli luajti kjo shkollë, nuk ka nevojë për komente. Vetëm të përkujtojmë se çfarë i kanosej shqiptarëve gjatë gjithë këtyre shekujve nën dhunën dhe terrin obskurantist të Perandorisë Otomane, e më pas nga pushtuesit serb, dhe do kuptohet e tërë pesha e shkollës.

7. Nëse nën pushtimin Otoman ndodhi internimi i popullatës, nën pushtuesin serb ndodhi burgosja e mësuesit të kësaj shkolle, Don Mikel Tarabulluzit. Siç shkruan Dr. Nikolla Zhutiç, në librin e tij Vatikan i Albanci, Beograd, 200, f.105-106, Don Mikeli po bënte shqiptarizimin e fshatrave me popullatë serbe të besimit katolik (e ka fjalën për fshatrat Letnicë, Vërnakollë, Vërnëz, Shashar, vër. S.Gj.), se aktiviteti dhe veprimtaria e tij në përgjithësi dhe ajo në shkollë, në veçanti, ishte ndesh me politikën serbe. Për këtë arsye, më 24.07.1921 dënohet me 8 muaj burg (shkalla e parë e gjyqit në Gjilan), për t'u dënuar (nga Gjyqi i Apelit në Shkup), me 4 mars 1922 edhe me dy vjet të tjera, por që më ndërhyrjen e autoriteteve kishtare vendore, por edhe të diplomacisë së kohës, do të lirohet me 12.07.1922. Së fundi, jo rastësisht, ish Presidenti Rugova e dekoroi Don Mikelin me urdhrin Mësues i merituar i kombit.

8. Stublla, një fshat me rreth 3500 banorë, prej të cilëve diku 2900 janë të shpërndarë gjithandej nëpër Evropë e Amerikë duke formuar "kolonitë" e tyre në Itali, Zvicër, Gjermani, Austri e gjetiu. Është e dhimbshme të kuptosh që vetëm në Leco të Italisë ka diku 1000 qytetarë stubllas, ndërkohë që në Stubëll ka diku 600 syresh. Edhe në vitin 1937 Stublla ka pasur më shumë banorë, 703 gjithsejt. Megjithatë stubllasit e duan Stubllën e tyre dhe jetojnë me shpresën për kthim në vendlindje. Mbase kjo është edhe arsyeja pse kanë investuar në të gjitha projektet e Stubllës: rrugët, shkolla, ambulanca, qendra rinore (salla sportive, një sallë për aktivitete të ndryshme dhe një kuzhinë), një pjesë e ndriçimit të rrugëve të fshatit, parku etj.

9. Si famulli më vete, që nga viti 1905, Stublla njihet për përshtirërinë e saj. Ka diku rreth 30 priftërinj e mbi 50 murgesha që veprojnë kudo nëpër botë. Që nga viti 1961 në Stubëll shërbejnë Motrat Vinçenciane, të cilat njihen sidomos për punën e tyre të palodhshme në ambulancë. Si shprehje e përshtirërisë së popullit të Stubllës janë dhe festat e famullisë: Shën Jozefi, Zonja e Lurdit, Shën Gjergji, Shëna Prena, por edhe përkujtimi i mundimeve të Krishtit gjatë kohës së kreshmeve, përgjatë kodrës së stubllavaqës, për çka stubllasit ndërtuan "Rrugën e Kryqit", mbase e vetmja në hapësirën gjithëshqiptare.

10. Stublla sot ka dhe manifestimin fetar, kulturor, letrar e shkencor "Takimet e Don Mikelit", ndër manifestimet më të njohura e më dinamike në Kosovë, ndërkohë që me rëndësi për vizitorët është Muzeu i Shkollës së Parë Shqipe në Kosovë, Kryqi i Dokut martir, varret e disa martirëve, varret e Don Nikollë Mazarekut e Don Nikollë Sharbanovit (rumun), Kisha e Re (për arkitekturën e saj), por edhe "Udha e Kryqit".

Këto dhe shumë gjëra të tjera bashkë me konfiguracionin e përthyer e pamjen shumë tërheqëse të Stubllës përbëjnë një hartë të mirë kulturore për vizitorët.

Sprovë për portret

Krijuesi i sistemit diplomatik shqiptar

(Dy fjalë për autorin dhe librin "Negociatat, historia, teoria, praktika" të ambasadorit dr. Lisen Bashkurti, me rastin e ribotimit dhe i promovimit më 29 janar 2010 në Prizren)

■ SHKRUAN:
Qani MEHMEDI

Libri "Negociatat, historia, teoria, praktika" ka një rëndësi të jashtëzakonshme jo vetëm për studentët dhe studiuesit e diplomacisë e të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të drejtës ndërkombëtare, por edhe për të gjithë ata që merren me praktikën diplomatike në Kosovë dhe në hapësirën shqiptare. Ky libër, pra, i bashkëngjitet kështu natyrshëm gamës së kontributeve të jashtëzakonshme teorike të mendimtarit dhe diplomatit Lisen Bashkurti.

Lisen Bashkurti është fundamental. Ai krahas Ukshin Hotit, Arben Puto dhe shumë pak autorëve të tjerë tek ne, vë themelet tona të mendimit teorik modern në diplomaci dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ai është studios dhe i gjithanshëm, mbase, autori më shquar shqiptar në këto fusha. Në rreth 20 veprat e tij, ai na del logjik, narrativ, i bollshëm në informacion, i mprehtë në dioptri, i thellë e largpamës, me akribi shkencore por edhe me një stil që të jep kënaqësinë e të lexuarit. Mirëpo, ai para së gjithash është autor shqiptar, që ia jep vendin kombit tonë në rrjedhat e diplomacisë dhe i bën nder doktrinës sonë kombëtare. Pra, nuk ka dyshim se kontributi kryesor i ambasadorit Lisen Bashkurti në shkencën tonë ka të bëjë me shqiptarët në rrjedhat e diplomacisë. Me tre vëllimet e tij për diplomacinë shqiptare dhe për vëndin që zë kombi ynë në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në tryezat e mëdha diplomatike, ngrit sistemin më të kompletuar shkencor në këto fusha. Këto vëllime i konsideroj jo vetëm të rëndësishme fundamentele teorike por edhe vepra me rrezatime të gjithanshme në shumë drejtime të albanologjisë dhe të mendimit politik e filozofik shqiptar. Pra, Lisen Bashkurti u zbërthen shqiptarëve

enigmat e qenësisë së tyre në diplomaci dhe në marrëdhënie ndërkombëtare dhe labirintet nëpër të cilat ka kaluar kombi ynë në këto rrjedha gjatë historisë. Ai është krijuesi i sistemit diplomatik shqiptar. Autori i librit "Negociatat..." edhe në praktikën politike e diplomatike, tashmë është shndërruar në një sinonim të krijimit të relacioneve në tërë hapësirën shqiptare dhe të shqiptarëve, sidomos me popujt ballkanikë. Dhe këtë mision mund ta kryejnë vetëm personalitete të kalibrit të jashtëzakonshëm siç

Bashkurti është një nga më të rrallët personalitete shqiptare sot që është bashkëbisedues vital me opinionin e gjerë publik kombëtar e ndërkombëtar. Oratorinë, dhunti kjo e rrallë ndër ne, atij ia pranojnë edhe ithtarët por edhe kundërshtarët, ashtu si edhe shpirtin e gjallë që vazhdimisht reflekton energji pozitive dhe hap rrugë të panjohura dhe pak të njohura. Në oratori, ai, mbase, mund të renditet fill përkrah Fan Nolit dhe sot në hapësirën shqiptare ai në këtë fushë nuk ka një të dytë. Lisen Bashkurti para së gjithash është

studious dhe penë aktive. Mendjehollë, i flaktë, dinamik, i kualifikuar - ai sikur është i dedikuar për këto kohë të vështira që i ka kaluar dhe ende i kalon kombi ynë dhe institucionet shqiptare për të hapur shtigje edhe atje ku të tjerët nuk shohin fare mundësi. Ai, pra është nga ata personalitete të rralla që i kemi ne shqiptarët, i cili ka mësuar tejet shumë nga historia për ta vënë atë në funksion të proceseve të sotme dhe në funksion të ardhmërisë së kombit tonë. Nuk mund ta përfundoj këtë fjalë rasti pa thënë edhe diçka: këtë personalitet të rrallë, këtë burrë me aftësi të jashtëzakonshme shtetndërtuese dhe shtetvepruese, këtë mendimtar e teorik të diplomacisë e të marrëdhënieve ndërkombëtare, injoranca që dominon klasën tone politike e diplomatike sikur

dhunshëm e mban në margjina të vendimmarrjeve, në radhë të parë shtetërore, por edhe të atyre kombëtare. Unë jam i sigurt se njerëzit dhe koha edhe të shqiptarët formatet e këtylla të personaliteteve, do ti vë në vendin e duhur. Jam i sigurt pra, se të gjitha veprat e Lisen Bashkurtit, edhe kjo "Negociatat, historia, teoria, praktika" gjithnjë e më shumë do të lexohen dhe gjithnjë e më lartë do të vlerësohen ashtu si edhe veprimtaria praktike e diplomatike e autorit të këtij libri. Jam i bindur se shpirti i tij krijues, kompetenca e tij shkencore, dhe energjia e tij e jashtëzakonshme për punë, shqiptarëve do t'u japin edhe vepra të tjera po kaq të rëndësishme apo edhe më të rëndësishme.

AKADEMIA DIPLOMATIKE SHQIPTARE



Lisen Bashkurti



NEGOCIATAT
Historia, teoria, praktika

është ai. Ai - erudit, dijetar i fushave nga më të ndryshmet edhe i atyre artistike, arsimim ky themelor i tij. Ai - poliglot e kureshtar, i gatshëm dhe i përgatitur për të bërë analiza dhe për të nxjerrë sinteza në radhë të parë për rrjedhat e historisë së kombit tonë por duke nxjerrë edhe mësimet dhe duke prognozuar kahjet. Ai - ndërmjetësues, jo vetëm brenda hapësirës shqiptare por edhe jashtë saj, gjithherë e vazhdimisht në funksion të ngritjes së kapaciteteve të faktorit shqiptar në Ballkan. Ai - ligjërues në shumë universitete kombëtare e akademie ndërkombëtare, jep kontribut të jashtëzakonshëm që e vërteta dhe dija për shqiptarët të arrijë edhe te miqtë edhe te armiqtë e kombit tonë. Ambasadori Lisen

Figura biblike

Zoja e Bekuar – Virgjëra Mari

Lexues të dashur,

Fillojmë me një rubrikë të re në këtë revistë: FIGURA BIBLIKE. Këto figura biblike do të përpiqemi t' i sjellim sa më të qarta, në situata e këndvështrime të ndryshme, në shërbim të rritjes së fesë sonë në Jezu Krishtin – i cili është qendra, burimi dhe qëllimi i historisë së Shëlbimit.

Figurat nga Bibla nuk do t' i prezantojmë në bazë të rëndësisë, sipas nesh, të veçantë, por mundësisht duke iu përshtatur kohës liturgjike, ndonjë rasti që ka të bëjë me personazhin në fjalë ose në kontekstin e ndonjë feste që bie në atë kohë /që del Drita/. Fillojmë prej atyre nga Besëlidhja e re.

■ SHKRUAN:
m. Ollga DULAJ

Se sa është e njohur Zoja e Bekuar dhe njëkohësisht e dashur nga besimtarët, dëshmon përvoja e besimtarëve, me të dhe fakti se ajo ka qenë dhe vazhdon të jetë mbështetja dhe uzdaja më e sigurt, nënë për të gjithë ata që e pranojnë Jezu Krishtin për Shëlbues.

Jam e bindur se nuk ka shtëpi ndër besimtarë që nuk e ka truporen, figurën e Zojës së Bekuar apo Rruzaren e saj dhe që nuk ka një devocion të veçantë ndaj Nënës qiellore-Mbretëreshës së Qiellit e të Tokës.

Megjithatë, pasi që jemi në kohën e Krezhmeve, bazuar në Shkrimin Shenjt, do ta sodisim figurën e saj nga këndvështrimi i përcjelljes së Birit të saj - Jezu Krishtit në çastet e vuajtjeve – në bartjen e Kryqit, në mundime, e vdekjen e Tij për ne.

Ajo është bashkëvuajtëse dhe bashkëshëlbuese me Birin e saj. Vuajtjet e saj në të vërtetë filluan jo në Kalvar, por qysh se i lajmëroi engjëlli Gabriel, se do të mbetet shtatzënë për virtyt të Shpirtit Shenjt. Jemi në kontekstin e kësaj feste, pra Lajmërimi Zotit /Zoja Nunciatë/ dhe në kohën e Krezhmeve, prandaj dhe këtë figurë do ta sodisim në këtë këndvështrim. Përmes Virgjërës Mari plotësohet Besëlidhja e vjetër në Besëlidhjen e re. Në PO –në e saj, si përgjegjëse vullnetit të Zotit, gjithë njerëzimi gjeti shëlbimin. Mirëpo, ky pranim i vullnetit të Zotit, që në të ngjizet Biri i Zotit dhe ajo, virgjër, të bëhet nëna e Zotit, ngërthen në vete një seri vuajtjesh e sfidash, megjithëse engjulli, në të përshëndetur, i kishte thënë: “Të falem, hirplotë!” Si është e mundshme që një hirplotë të vuajë kaq shumë? Një e zgjedhur prej Zotit, të mos jetë e kursyer nga “shpata që ia shpon shpirtin”? /krh. Lk 2, 35/. Vuajtja pra, për atë që i dorëzohet vullnetit të Zotit, nuk është dënim, por shoqërimi nga ana e Zotit dhe besimi që Zoti ka në të. Maria e heq velin e turpit nga shpjegimi se vuajtja është dënim prej Zotit.

Pra, në Zojën e Bekuar shohim një nënë të përkryer, që krahas privilegjit me



qenë nënë, bart me vete edhe përgjegjësinë e madhe të kësaj thirrjeje, përkundër dhembjeve e vuajtjeve.

Atë e përcolli befasia dhe sfida e paparë, se për virtyt të Shpirtit Shenjt të mbetet shtatzënë /krh. Lk 1, 28-32/. Nuk kuptoi pothuajse asgjë, por e dorëzuar krejtësisht Zotit, pranoi gjithçka. Dorëzimi i saj, i shprehur me fjalët: U bëftë siç the ti! qe një përcaktim fundamental, pas të cilit qëndroi deri në fund, duke u rritur edhe vetë në përfundim të këtij qëndrimi jetësor. Kështu ishte e edukuar nga prindët e saj, Ana e Joakimi. Kështu edukohet dita-ditës në praninë Shpirtit të Zotit që ishte në të. Krejt e zbrazur nga vetvetja, duarhapur pranoi nga Zoti atë që Ai i dhuroi. Ishte kjo urtia që e ndihmoi t' i dalë përballë Shën Jozefit si një shtatzënë /pa pasë njoftë burrë paraprakisht/. Të mendojmë vetëm përjetimin e mospranimit të një shtatzëne në qytetin e Betlehemit për të lindur fëmijën e vet dhe varfërinë e skajshme

në shpellë ku lindi Jezusi! Me Urtinë – që u mishërua në të, Birin e Zotit që po e bartte nën krahorr, u bëri ballë shqetësimeve e telasheve që lindën pikërisht nga ky fakt: se shumëkush e ndjen veten të rrezikuar me ardhjen e Zotit në tokë /krh. Lk 2,34/. Duke ikë nga Herodi, në një anë anë shpëtonte familjen, e në anën tjetër rrezikoi sigurinë e saj e të fëmijës. Këtë mund ta ndjejë vetëm një zemër nënë. Tërë jeta e saj qe një udhë e Kryqit. Dhembjet e zemrës së Zojës së Bekuar nuk kanë të ndalur, qysh nga fëmijëria e Jezusit. Sa telashe një herë që kishte pasur, kur ai u mbet në tempull të Jeruzalemit, megjithëse në mesin e dijetarëve /krh. Lk 2, 41-50/: çka do të thotë për një nënë t' i humbë fëmija e të mos mund ta gjejë tri ditë! Nuk është e lehtë të edukosh e t' i dalësh ballë një fëmije inteligjent, si ishte Jezusi.

Në të gjitha momentet e mundimeve, paqartësive, vështirësive, Maria ka ditur të përmbahet, të intervenojë

në vend e kohë të duhur, të vë re atë për çka njeriu vuan e ka nevojë dhe me gëzim e disponim të mirë shpirtëror të ruajë zgjuarsinë dhe drejtpeshimin e një virgjëre e nënë. Në dasmën në Kanë /krh. Gj 2, 1-12/, Maria bashkëndjen me dasmorët që mbetën pa verë dhe nuk e lë dhëndrin të koritet e t' i ndërpritet gëzimi. Ishte kjo shijim i asaj dasme të madhe, ku dhëndri i vërtetë është vetë Biri i saj, që verën e shndërron në gjak – të derdhur për të gjithë njerëzit për të cilët flijohet, në mënyrë që të gjithë të shijojnë gëzimin e amshuar –në dasmën e madhe të Mbretërisë qiellore.

Maria vuan shpirtërisht edhe në kohën e veprimtarisë publike të Jezusit: kur po e kundërshtonin vazhdimisht farisenjtë, skribët... Kur po përflitej se është jashtë vetes. Asaj vazhdimisht një shpatë po ia thehte zemrën, si pat profetizuar Simon plaku / Lk 2,35/. Ajo pra, vazhdimisht po ecte në udhën e kryqit, sepse edhe mundimet e

Birit të saj nuk filluan në Kalvar, por prej se u bë njeri. Po veçoj vetëm disa nga momentet e dhembjes së Zojës së Bekuar. Në pushimin e katërt të Udhës së Kryqës, kujtojmë: Jezusi takon nënën e vet! – Takim shikimesh që flasin e thonë shumë, por në heshtje. Shikimit në dhembje nuk i nevojitet fjala, sepse atë e kupton ai që ndjen dhembje me të. Kush ndjeu dhembje më shumë atëherë, nuk e dimë: Biri që po e shikonte nënën apo nëna që po e shikonte Birin. – Zoja e Bekuar është mësuesja dhe edukatorja që me shembull udhëheq ata që u janë besuar: në dhembje mësohet të dojë dhe se kush do, mëson nga ajo si bartet dhembja.

Ajo qëndroi pranë Birit të saj në kryq: Në këmbë, përbri kryqit të Jezusit, qëndronin nëna e tij, Maria e Kleopait edhe Maria Magdalenë. Jezusi kur pa nënën e vet dhe, pranë saj, nxënësin që e donte, i tha nënës: „Grua, qe, biri yt! Mandej i tha nxënësit: „Qe nëna jote!“ Prej kësaj kohe nxënësi e mori me vete /Gjn 19, 25-27/.

Qëndrimi i saj në këmbë, përbri kryqit të Jezusit, shpreh gatishmërinë e saj, gjendjen aktive, bashkëvuajtjen me të Birin e vet. As edhe një fjalë nuk u dëgjua nga goja e saj. Mjaftonte dhembja që ndjente. Mjaftonte prania e saj, jo nën kryq ulur, por në këmbë, përbri kryqit. Nxënësi që e donte Jezusi(n) ishte pranë saj.

Duke e soditur figurën e Zojës së Bekuar në këtë prizëm, këto ditë të Krezhmeve, si bijtë e bijat e saj, veçanërisht jemi të thirrur, të vërejmë pozicionin tonë shpirtëror në jetën tonë përballë Krishtit që po vuan. Të qëndrojmë prandaj, me Zojën e Bekuar, përbri kryqit, në këmbë – të gatshëm për të bashkëndarë vuajtjen e Trupit të tij Mistik – Kishës. Të kundrojmë jo si shikues, por si pjesëmarrës të këtyne mistereve që Kisha po i kujton këtyre ditëve, duke kërkuar hir që vuajtjen ta pranojmë e ta bartim me Zojën e Bekuar, si nxënësi të vërtetë. Të mësojmë nga Jezusi i tradhtuar, i nënçmuar, i përbuzur, i rrahur, i përgjakur, i kryqëzuar duke e shikuar në sy me qëndrimin tonë përballë tij. Bëftë Zoti, që agimi i ditës së Pashkëve të na gjejë duke e shikuar këtë të Vërtetë në sy.

Grindjet dhe konfliktet bashkëshortore

■ SHKRUAN:
Dr. Pavao Brajša

Nëse martesë apo ndonjë formë tjetër e një raporti më të gjatë intim të ndërsjellë nuk mund të ekzistojë pa dashuri, qoftë në kuptimin e ngushtë apo të gjerë të fjalës, atëherë e njëjta gjë gjithsesi vlen edhe për grindjen, siç e kuptoj dhe interpretoj unë. Konfliktet janë pjesë përbërëse e çdo marrëdhënie të gjatë, kështu që ekzistojnë edhe mënyra të ndryshme të sjelljes ndaj tyre. Në një marrëdhënie të tillë duhet të grindemi ose mirë ose keq, ose suksesshëm ose pasuksesshëm, ose konstruktivisht ose destruktivisht. Kjo na detyron që për grindjet të reflektojmë dhe të mundohemi t'i bëjmë të mira, cilësore, të suksesshme, konstruktive dhe t'i shndërrojmë në shanse të përditshme të një njohjeje të ndërsjellë më të mirë, të një përshtatje më cilësore të ndërsjellë dhe një mbijetese më të lumtur të përbashkët.

Fjala është për një temë mjaft praktike që është e lidhur me jetën e përbashkët konkrete të të dyve bashkë dhe të cilën nuk mjafton ta njohësh, por duhet ta mësosh dhe ta dallosh në situata konkrete, si dhe ta zbatosh në to. Për këtë arsye kam vendosur të shkruaj për grindjen në martesë thjeshtë dhe kuptueshëm dhe t'i nxis lexueset dhe lexuesit e kësaj kolumne të revistës për të reflektuar mbi vetveten dhe për ta analizuar situatën personale prej partneri, të jetës martesore.

Në të folurit e përditshëm me grindje nënkuptohet diçka negative, e keqe, e pahijshme dhe gjithë ajo që në këtë duhet t'i shmangesh. Me këtë koncept zakonisht lidhen edhe shprehjet apo sintagmat: përçarje, zënkë, të grindesh deri në rrjedhje gjak, të kapesht fyt për fyt, rrache e madhe, të futësh përçarje dhe armiqësi ndër ata që janë të pajtuar, të ndash njërin nga tjetri, mos të marrit vesh fare, përleshje, inat, zihje. Në fjalorët tanë njeriu që grindet quhet grindavec, grindar, thyesh, çdo njeri që krijon përçarje. Shihet që grindja vlerësohet në mënyrë negative dhe përshkruhet si diçka e keqe, e padëshiruar, rrënuese, që njerëzit i ndanë në mes veti dhe i shkatërron.

Kjo i përshtatet mendimit të përgjithshëm dhe të rrënjësor se grindja është gjithmonë diçka negative që duhet shmangur, të cilës duhet t'i rrish larg, që nuk i takon një marrëdhënieje cilësore martesore, që gjithmonë është shenjë e një qëndrimi armiqësor ndër çiftet martesore.

Grindja konsiderohet pjesë përbërëse e një jete jociësore të marrëdhënieve të çrregulluara. Grindjen zakonisht e fusim në sjelljen e pahijshme dhe të papërshtatshme që gjithmonë sjell dëm edhe njëerës edhe anës tjetër, pasojat e së cilës janë gjithmonë negative dhe që në vete ka gjithmonë diçka shkatërruese.

Marrja ime vërtet e gjatë me problematikën martesore dhe familjare më jep të drejtën të pohoj të kundërtën. Për mua grindja është pjesë përbërëse e çdo martesë të shëndoshë dhe normale apo të çfarëdo marrëdhënie tjetër të gjatë. Nuk është problemi se a po grindemi në martesë apo nuk po grindemi, por si grindemi dhe çfarë pasojash lënë grindjet tona martesore. Për këtë dëshiroj të shkruaj dhe të reflektoj së bashku me ju në vazhdimësinë e kolumnës sonë.

Grindja e mirë dhe e keqe në martesë

Me nocionin grindje gati gjithmonë lidhet pozita e ngadhënjyesit dhe të mundurit, të atij që fiton dhe të atij që humb, salvuesit dhe viktimës, të atij që ka dhe të atij që nuk ka të drejtë, të atij që ofendon dhe të atij që është i ofenduar, të atij që është më i fortë dhe të atij që është më i dobët. Nga grindjet gati gjithmonë njëra anë del e pakënaqur kështu që mundohet të hakmerret dhe t'ia kthejë „duke mos i mbetur borxhli“, gjë që nxit një zinxhir të pafund të grindjes së sërishme, dhe kështu gjithçka shndërrohet në „rrethin magjik“ brenda së cilit rrotullohem dhe nga i cili nuk ka dalje.

Ta pyesim veten se a duhet gjithë kjo patjetër të jetë vërtet kështu? A është grindja vërtet gjithmonë diçka negative dhe a duhet gjithmonë ta shmanjim? A është fare e mundshme jeta e njerëzve pa grindje? A nuk është grindja e përshkruar vetëm teknikë e keqe e të grindurit? A nuk është një grindje e tillë vetëm mënyrë e keqe dhe e gabuar e sjelljes kundrejt konflikteve martesore? A duhet patjetër që në çdo grindje të dominojë agresioni shkatërrues dhe armiqësia e hapur në mes çiftit martesor? Çfarë roli luan në grindje konflikti dhe agresioni? A ekziston fare edhe ndonjë grindje tjetër përveç kësaj që e përshkruam?

Për këto pyetje duhet reflektuar dhe atyre duhet t'iu përgjigjemi. Kjo është e nevojshme në mënyrë që të mund t'i kuptojmë grindjet martesore, në mënyrë që të mundemi më vonë t'i përgjigjemi pyetjes se a është fare e mundur martesë pa grindje dhe si duhet të sillemi

me grindjet në martesë.

Tash për tash do të kënaqemi me një pohim të përgjithshëm, që do të mundohemi ta shpjegojmë dhe ta provojmë, që është: Grindja martesore, në kuptimin e saj të zakonshëm dhe negativ, është mënyrë e keqe dhe e gabuar e sjelljes kundrejt konflikteve martesore që janë të domosdoshëm dhe pjesë përbërëse e të gjitha martesave. Një grindje e tillë është e keqe sepse në të është i përfshirë agresioni shkatërrues. Ajo është rezultat i marrëdhënieve të këqija në martesë, i një komunikimi të mangët dhe jo të barabartë, i një përdorimi të dyanshëm të pakënaqur të përbashkët. Me shmangien e grindjes së ndërsjellë dhe me mohimin e konflikteve të ndërsjella problemet martesore nuk zgjidhen.

Përveç një grindje e tillë, negative dhe të keqe, ekziston

“ Grindja martesore, në kuptimin e saj të zakonshëm dhe negativ, është mënyrë e keqe dhe e gabuar e sjelljes kundrejt konflikteve martesore që janë të domosdoshëm dhe pjesë përbërëse e të gjitha martesave. “

edhe ajo pozitive dhe e mirë. Parakushti i saj është pranimi i konflikteve, përdorimi i agresionit kreativ, kultivimi i marrëdhënieve cilësore ndërnjerëzore, komunikimi i hapur dhe i qartë ndërnjerëzor dhe mundësimi i përdorimit të dyanshëm të kënaqur dhe të barabartë, të drejtë të përbashkët. Këtë duhet mësuar gjatë martesës dhe në vazhdimësinë e saj duhet ta përsosësh në mënyrë permanente. Me fjalë të tjera: nuk është lehtë të grindesh mirë, mirëpo është e domosdoshme nëse dëshiron të jetosh në mënyrë cilësore dhe njerëzore në martesë.

Konflikti martesor

Në çdo konflikt duhet dalluar palët e konfliktit, d.m.th. ata ndër të cilët është shkaktuar konflikti, pastaj fushën e konfliktit, ky është vendi në të cilin ka ardhur deri te konflikti, dhe dinamikën e konfliktit, d.m.th. mënyrën e sjelljes me konfliktin të atyre që ndodhen në konflikt.

Po ashtu duhet dalluar konfliktin brenda individit dhe konfliktin në mes individëve. Në rastin e parë kemi të bëjmë me një konflikt të brendshëm, shpirtëror që individi e përjeton në veti, kurse në rastin e dytë me konfliktin e jashtëm, me konfliktin ndërnjerëzor që lajmërohet në mes individëve.



Meqenëse në mënyrë të veçantë do t'i kushtohemi konfliktit martesor, në rastin tonë palët e konfliktit paraqesin partnerët martesor, fushën e konfliktit e paraqet situata martesore, kurse dinamika e konfliktit do të thotë sjellja me konfliktin në martesë, mund ta quajmë - grindje martesore.

Konfliktet mund t'i ndajmë më tutje në të fshehura dhe evidente. Në rastin e parë nga jashtë nuk tregojmë se jemi në ndonjë konflikt, këtë e përjetojmë në veti dhe mundohemi që këtë mos ta tregojmë në sjelljen tonë ndaj tij. Një konflikt të tillë e mbartim në veti, e shtypim, e mbajmë në brendësinë tonë, dhe kjo na bën të acaruar, jo të disponuar dhe shpesh herë vetëm është çështje kohe se kur do të plas konflikti në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë dhe të tregohet në sjelljen e jashtme të një çifti martesor kundrejt të tjerëve. Në rastin e dytë konflikti shihet qartë në fjalë, gjeste dhe në sjelljen e tërësishme të partnerit martesor ndaj atij me të cilin ai është në konflikt.

Përveç kësaj, në çdo konflikt duhet dalluar problemet e një-menda që kanë prurë deri te konflikti, gjendjen emocionale të pjesëmarrësve të konfliktit, vështrimin dhe interpretimin personal të asaj çfarë ndodh gjatë konfliktit dhe sjelljen evi-

dente konflikteve. Nuk është krejt njëjtë se me çfarë ndjenjash i qasesh konfliktit, çfarë shihet dhe vërehet, se si interpretohet kjo. Të gjitha të përmendurat kanë ndikim të rëndësishëm në sjelljen konflikteve të partnerit martesor dhe shpesh herë pikërisht ajo më shumë e përcakton mënyrën e sjelljes së partnerit martesor me konfliktin, d.m.th. sjelljen e tij në konflikt, sesa faktet e njëmenda që kanë prurë deri te konflikti.

Është shumë me rëndësi përjetimi personal i konfliktit të atyre që ndodhen në konflikt. Përveç kësaj në çdo konflikt të ri te çifti martesor ndikojnë pasojat e konflikteve më të hershme me të njëjtin partner.

Konfliktet në martesë janë fenomen normal dhe i shëndoshë. Nuk janë shenjë e martesës çrregulluese apo të sëmurë. Pikërisht është e kundërta. Martesat e sëmura dhe të çrregulluara shpesh herë janë pa konflikte dhe grindje sepse të gjitha këto ndrydhen dhe përjetojnë në vetë, gjë që në mënyrë të pakontrolluar dhe pavetëdijshëm i prish marrëdhëniet martesore dhe i kontribuon zhvillimit të pengesave psikosomatike madje edhe sëmundjes te çiftet martesore.


(Përktheu:
P. Shitjefën Dodes SJ)

Ndihma (udhëzime) shpirtërore për të kuptuar dhe jetuar kreshmët

■ SHKRUAN:
Don Nikson Shabani

Koha e shenjtë e Kreshmëve është periudha me në shenjë e jetës liturgjike. Është pra kohë pendese, agjërimi, lutjeje dhe e veprave të mira të dashurisë, në të cilën populli i Hyjit përgatitet për t'i kremtuar Pashkët apo Ringjalljen e Jezu Krishti. Përbëhen prej dyzetë ditëve, që fillojnë të Mërkurën e përhime e përfundojnë të Shtunën e madhe me meshën e mesnatës. Është e ndarë në dy periudha gjashtë javore: periudha e parë janë katër të dielat e para që quhen edhe të dielat e kreshmëve dhe dy javët e fundit të cilat quhen Java e Mundimeve dhe Java e Madhe apo e Shenjtë që është edhe pjesa kryesore e Kreshmëve.

Fjala Kreshme rrjedh prej fjalës latine "Quadragesima die" dhe donë të thotë: katërdhjetëditëshi. Kreshmët u themeluan në shekullin e IV. Historia e saj para këtyre viteve është jo shumë e qartë. Në shekujt e parë tek të krishterët praktikoheshin pendesa vetëm për një apo dy ditë në kujtim të kohës në të cilën Krishti vdiq e qëndroi në varr, d.m.th., të Premten dhe të Shtunën e madhe. Duket se ajo ka rrënjët e veta në pendesën të cilën e kanë mbajtur kandidatët, katekumenët, për pagëzim në vigjiljen e Pashkëve, dhe dal nga dalë kjo hapësirë është zgjatur në një javë, pastaj tri sipas regjioneve të ndryshme, veçanërisht në lindje, deri në gjashtë javë e pastaj në katërdhjetë ditë. Kuvendi i Nikesë në vitin 325, flet për kohën e katërdhjetë ditëve të përgatitjes për Pashkë, kurse në fund të shekullit të IV, pendesa dhe agjërimi përbëheshin prej katërdhjetë ditëve para Pashkëve, dhe kjo pendesë është mbajtur gjithkund si në Lindje ashtu edhe në Perëndim, dhe mund të themi se mu këtu vetëm e kemi të formësuar kohën e Kreshmëve. Sipas origjinës ato fillonin të dielën. Por më vonë, në shekullin e VI dhe VII erdhi në shprehje si karakteristike dominuese pendesa e agjërimi, kurse të dielën nuk mbahet agjërimi, dhe filloi të praktikohet fillimi i tyre të mërkurën para të dielës së parë, që në vazhdueshmëri do të quhet e Mërkura e përhime, që kështu Pashkët të përcillen me 40 ditë agjërimi e pendesë efektive.



“Kreshmët ndihmojnë që të krishterët ta kujtojnë mëkatësinë e vet dhe nevojën që ti kthehen shenjtërisë së pagëzimit.”

Pse 40 ditë?

Kësaj periudhe të përgatitjes për Pashkë i ka dhënë kuptim dhe i ka kontribuar natyrisht simbolizmi biblik i numrit katërdhjetë (40). Ai ka rrënjët e veta në pendesën katërdhjetëditore ditore të Mojsiut, Elisë dhe Jezu Krishtit. Përfundimisht gjatë shekullit IV, sipas shembullit të Krishtit në shkretë, bënin hyrje katërdhjetë ditë përgatitje, duke filluar prej të dielës së gjashtë para Pashkëve. Ky simbolizëm vazhdon më tutje: **a)** Ndodhitë e katërdhjetë ditëve të përmbytjes së përgjithshme me ujë para besëlidhjes me Noen; **b)** Katërdhjetë ditët e Mojsiut që i kaloi në malin Sinaj para se të takohej me Hyjin; **c)** Katërdhjetë vitet e popullit të Izraelit që i kaloi në shkretëtirë para se të hynte në tokën e premtuar; **d)** Katërdhjetë ditëve që profeti Elia i kaloi në shkretë para se të takohej me Hyjin në malin Horeb; **e)** Katërdhjetë ditët e pendesës të banorëve të Ninivës dhe mbi të gjitha të katërdhjetë ditët të Jezusit të kaluara në shkretëtirë para se të fillonte misionin e tij mesianik. Të gjitha këto kanë të përbashkët faktin se hapësira e kësaj kohe shërben për provë, për pastrim e përgatitje për një ndodhi të rëndësishme e shëlbimprurëse.

Simbolizmi biblik i thënë më lart ka edhe vlerën e vet didaktike sepse Kreshmët janë kohë: **a)** Kur ne me pendesë, agjërime, lutje e vepra të dashurisë mundohemi ta mundim e ta zhdukim të keqen prej jetës sonë, sikurse që e keqja u zhdruk në

njerëzit e përmbytjes; **b)** Kohë e tundimit por edhe e hirit, si kurse që ishte për Izraelin në shkretë, që të mundemi të përcaktohem për Hyjin dhe jetën tonë ta drejtojmë ka Ai; **c)** Është kohë lutjeje intensive; lutje e cila na aftëson që të largohemi prej mëkatit, të keqes dhe të takohemi me Zotin, sipas shembullit të Mojsiut dhe Elisë; **d)** Kohë pendese kur ne "shmojmë" duke përkujtuar gjyqin e Hyjit e po ashtu edhe kohë kur ne imitojmë katërdhjetë ditët e pendesës sipas shembullit të banorëve të Ninivës, me shpresë se do të zbusim hidhërimin e Hyjit; **e)** Kohë pendese që të aftësohemi për të kryer përherë e përgjithmonë vullnetin e Atit tonë qiellor, dhe të ushqehemi me bukën e vërtetë, Jezu Krishtin, i cili në vete mban Jetën e Pasosur, në fakt vet Ai është Jeta e Pasosur. Dhe do të thonim së bashku me Shkrimin Shenjtë, kohë e vlefshme për të qëndruar së bashku me Virgjëren Mari, Zojën e Bekuar dhe me Shën Gjonin, nxënësin e dashur, afër Krishtit i cili në kryq e flizon jetën e vet për gjithë njerëzimin (Gjn 19, 25).

Karakteristika kryesore apo parësore e kreshmëve është pendesa, natyrisht duke mos i lënë anësh edhe lutje dhe veprat e dashurisë. Në fillim pendesa ishte e ashpër dhe lejonte vetëm një shujtë në ditë, e cila merrej në mbrëmje. Ishte e ndaluar marrjen e mishit të peshkut dhe mishit tjetër, në disa vende ishin të ndaluara edhe prodhimet e

qumështit, tek ne është e ruajtur kjo traditë deri në ditët e sotme. Duke filluar e prej shekullit IX, pendesa u lehtësua duke u lejuar të merret peshku, vezët dhe shujta është tërhequr në mesin e ditës. Në shekujt e me vonshëm lejohej mishi, përpos të premtën, dhe theksi për kuptimin e kreshmëve është ndërruar. Me shekuj qëllimi i kreshmëve është vënë në vuajtjen fizike. Konkili II i Vatikanit ngadalë i ka dhënë theks përgatitjes shpirtërore për misterin e Pashkëve dhe e ka zgjeruar pendesën në formë të tjera duke i shtuar lutjen dhe veprat e dashurisë. Tri aspekte të kreshmëve, lutja, pendesa-agjërime, dhe veprat e dashurisë nuk janë qëllime për vete, por mjete që i krishterët të përgatitet për kremtimin e Ringjalljes së Zotërisë. Kreshmët ndihmojnë që të krishterët ta kujtojnë mëkatësinë e vet dhe nevojën që ti kthehen shenjtërisë së pagëzimit.

Karakteristika e dytë e kreshmëve janë veprat e dashurisë që burojnë nga pastërtia e jetës. Kisha kërkon prej nesh që në këtë kohë të shenjtë të mundohemi të largohemi prej mëkateve e të ushtrohemi në virtyte, që të mundemi përherë të rritemi shpirtërisht e të marrim shprehje për të bërë mirë me shpresë se ajo do të vazhdojë në të gjitha ditët e jetës sonë.

Dhe karakteristika e tretë është urata apo lutja. Ajo është mjet i domosdoshëm për shëlbim, dhe Kisha lutet sipas shembullit dhe porosisë së Zotit tonë Jezu Krishtit, duke e pri-

tur ardhjen e tij. Lutja e aftëson shpirtin që ta takojë Zotin. Ajo e liron shpirtin e njeriut prej të gjitha gjërave që e ndalojnë që të ngritët drejt Zotit dhe e bën të tillë që t'i pëlqejë Zotit e ashtu kjo kohë "bëhet një përvojë e rilindur e dashurisë së Zotit që na është dhuruar në Krishtin, dhe këtë dashuri ne duhet ditë për ditë t'ia dhurojmë të afërmeve tanë, sidomos atyre që vuajnë dhe të cilëve u është e nevojshme. Sepse vetëm kështu do të mund të marrim pjesë në gëzimi e Pashkëve", Na porosit papa Benedikti XVI në porosinë e tij për Kreshmët 2007.

Cilat janë praktikatat e kreshmëve?

Kreshmët përmbajnë në vete një angazhim asketik, individual dhe kolektiv, ndër të cilat format më tradicionale janë lutja: mesha e përditshme, mbi të gjitha Udhë e Kryqit të premteve, të mërkurave apo edhe ditëve të tjera; Pendesa e ninesa, së bashku me praktikatat e refuzimit (refuzimi i ushqimit, fjalëve, kënaqësi të ndryshme, parave etj.). Refuzimi na premton një disponim për të afërmin, më shumë kohë për të tjerët dhe vepra të dashurisë; Lëmosha: ndihma ndaj të afërmit që ka më shumë nevojë për ne. Në kreshme Kisha na kujton dhe na thërret të bëjmë pendesë e agjërime: të Mërkurën e Përhime dhe të Premten e Madhe. Të mos hamë mish secilën të premte të Kreshmëve. Kisha po ashtu na rekomandon, në mënyrë të posaçme veprat mëshirshme të trupit: 1. Jëpi bukë të uriturit; 2. Jëpi ujë të eturit; 3. vishe të zhveshurin; 4. Strehoje shtegtarin; 5. Vizitoje të sëmurin; 6. Vizitoje të burgosurin; 7. Varrose të vdekurin; dhe veprat e mëshirshme të shpirtit: 1. Këshilloji ata që dyshojnë; 2. Mësoji të paditurit; 3. Qortoji mëkatërit; 4. Ngushëlloji ata që vuajnë; 5. Fali fyerjet; 6. Duroji ata që të mërzisin. Këto praktika theksojnë shndërrimin në raport me vetveten, në raport me Hyjin dhe në raport me të tjerët. Në fund po e përfundoj me fjalët e Enciklikës "Mediator Dei" të papës Piu i XII: "Në ditët e Kreshmëve Kisha, nënë e jonë, bën çmos që secili prej nesh të njohë ligësinë e vet dhe mjerimin, të nxitet me kujdes kah përmirësimi i dokojeve e t'i bijë mohit mëkateve duke i shlyer këto me anën e lutjeve dhe me pendesë, mbasi vetëm urata e vazhdueshme e pendesa për mëkatet të bëra na nxjerrin ndihmën hyjnore, pa të cilën çdo vepër e jonë është e kotë dhe e pafryt."

TË MËDHENJTË PËR HYJIN DHE BESIMIN

Një shkencëtar i madh, duke u kthyer në vendlindjen e tij, interesohej për miqtë e tij të dikurshëm, bashkëpunëtorët dhe të njohurit. Kur e kishte marrë vesh se njëri prej tyre më nuk ishte gjallë, qetë dhe përvujtërisht kishte uruar: “E mbuloftë edhe në amshim pelerina e dashurisë së krishterë...”

Ishte ky një njeri i cili gjatë tërë jetës së vet ka qenë i rrethuar me libra, ndërsa një vend nderi në tavolinën e tij e kishte libri i madh – Bibla. Le ta njohim mikun e Biblës, njërin prej mendjeve më të shkëlqyera të njerëzimit që ishte...

Wilhelm Conrad Röntgen

Në Muzeun kombëtar të Münchenit gjendet një përmendore e Wilhelm Conrad Röntgenit, në të cilën shkruan: “Rrezet e quajtura sipas tij ia tregojnë mjekut brendësinë e trupit të gjallë, inxhinierit brendësinë e materies, hulumtuesit lajmet mbi ndërtimin e brendshëm të atomit”.

Rrezet e Röntgenit kanë rëndësi të madhe për mjekësinë. Ato tregojnë vendin ku janë eshtrat e thyera, i zbulojnë sëmundjet e mushkrive, lukthit, zorrëve... Rrezet edhe i shëro-

jnë sëmundjet e ndryshme. Mirëpo, gjatë punës me rreze duhet pasur shumë kujdes, sepse ato mund të shkaktojnë ndezje dhe plagë. Rrezet kanë vend të rëndësishëm edhe në teknikë, sepse zbulojnë shumë gabime të padukshme për syrin e njeriut.

Nuk ka qenë “i shkëlqyeshëm”, por...

Wilhelm Conrad Röntgen u lind me 27 mars 1845 në një lagje gjermane Leneep. Në shkollë nuk ishte nxënës i shkëlqyeshëm, por tregonte durim dhe qëndresë në punë. Shumë eks-

perimente dhe netë pa gjumë në dhomën e errësuar i kanë sjellur lavdinë dhe zbulimin e madh. Ai vetë i pari i ka parë eshtrat e dorës së vet. Për këtë zbulim ka shkruar me 9 maj 1896, e disa ditë më pas e ka mbajtur një ligjeratë mbi “llojin e ri të rrezeve”.

Për zbulimin epokal e ka fituar çmimin e parë Nobel të ndarë për fizikë. Ka qenë i pranuar nga cari, i shpallur qytetar nderi i shumë qyteteve dhe ka fituar më shumë se njëqind dekorata dhe mirënjohje.

Puna e palodhshme e tij është reflektuar edhe në shëndetin e tij. Në vitin 1913 është shurdhuar në veshin e majtë e së shpejti fillojnë edhe gjakderdhjet e mushkërive. I pati marrë lakmi Metuzalemit, plakut i cili sipas tregimit biblik ka jetuar 969 vjet, dhe pati thënë: “Për gjithë atë kohë njeriu edhe do të mund të krijonte diçka!”

Röntgeni e kalonte kohën e lirë duke shëtitur, në gjueti ose me libër. Më se shumti i pëlqente shkrimtarët Stendhal dhe Cervantes, kurse prej kompozitorëve veprat e Mozartit, Beethovenit, Bachut dhe Brahmsit. Prej mësuesve të vet më së shumti e përmendte fizikanin Kundt.

Vdekja e babait dhe nënës së tij kanë lënë gjurmë plot



dhimbje, kurse me vdekjen e gruas së vet ka qenë krejtësisht i shkatërruar. Por, edhe më tutje punonte palodhshëm, deri në ditën kur gazetata lajmëruan: “Me 10 shkurt 1923, në ora 8,30

vdiq fizikani i madh Röntgeni, zbuluesi i rrezeve të panjohura të cilat janë quajtur me emrin e tij”.

Branko Pilaš
(përkth. m. T. A)

Darka e Jezusit

Përherë për festën e Pashkëve tek hebrenjtë është shtuar një darkë festive. Nxënësit ishin përgatitur për këtë festë dhe Krishti u ul në tryezë me ta. Ai u tha: “Kam shumë dëshirë të ha këtë darkë edhe një herë me ju! Sepse së shpejti do të vuaj shumë.

Mori bukën, shqiptoi lutjen e falënderimit, e theu dhe ua dha nxënësve të tij e tha: “Ky është trupi im, që do të flijohet për ju. Bëjeni këtë në përkujtimin tim”.

Pas bukës, mori edhe gotën me verë e tha: “Ky është gjaku im që do të derdhet për ju! Merrni dhe pini të gjithë prej kësaj gote! Kjo është Besëlidhja e Re që Hyji ka lidhur me popullin e tij”. Pak më vonë tha: “Njëri prej jush do të më tradhtojë.

Ata filluan ta shihnin njëri-tjetrin në sy: cili mund të ishte tradhtari?

Jezu Krishti u kthye kah Pjetri dhe i tha: “Pjetër, unë jam lutur për



ty që të mbetesh besnik. Pjetri iu përgjigj: “Jezus, Hyji im! Për ty jam i gatshëm të shkojë në burg, por edhe të vdes!”

Mirëpo, Jezu Krishti iu përgjigj: “Pjetër, ki kujdes sonde para se të këndoç gjeli; do të më mohosh tri herë”. Pasi përfundoi darka, Krishti shkoi në Malin e Ullinjve për tu lutur. Nxënësit e ndoqën pas.

Ai u largua pakëz prej tyre. Ra në gjunjë dhe filloi të lutet: “O Atë, mos lejo të vuaj. Megjithatë u bëftë vullneti yt e jo dëshira ime”.

Pastaj u shfaq një engjëll nga qielli dhe i dha forcë. Krishti u lut edhe më fortë. Nga vuajtjet që kishte djerstë e tij u bënë si pika gjaku që pikonin në tokë.

Ai u kthye përsëri tek nxënësit. Ata po flinin sepse ishin të lodhur. Krishti i zgjoi dhe i qortoi: “Përse po flini? Zgjohuni dhe lutuni që të mos bini në tundim. (Lk 22, 7-45).

TA NDIHMOJMË NDËRTIMIN E KATEDRALES

Jam mik i Kishës Katolike dhe dua ta ndihmoj ndërtimin e Katedrales “Nëna Terezë” në Prishtinë!

Gjithë juve miq dhe bamirës të dashur, ju mundësojmë ta jepni kontributin përmes xhirollogarive bankare.

Faleminderit!



Raiffeisen BANK
Kosovo J.S.C.
Prishtina, Kosovo
SWIFT code: RBKORS22

Adm. Ap. e Prizrenit
Numri i llogarisë:
EUR: 1501 090000 1990 20
USD: 1501 090000 3765 30
CHF: 1501 090000 3764 33

Valuta	Banka	Shteti	SWIFT/BIC
EUR	Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG	Vienna, Austria	RZBAATWW
USD	American Express Bank, LTD	New York, US	AEIBUS33
CHF	UBS AG	Zurich, CH	UBSWCHZH80A



Ti që e do Nënë Terezën dhe ndërtimin e Katedrales, uroje, ndihmoje, realizoje, duke thirrur në numrin

0900-901-101

Çdo thirrje e jote të kushton një euro.

Drita

"Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon."

KEPILLER

E PËRMUAJSHMË PËTARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prishtinë • Janar 2016 • Viti XXVII • Nr. 1 (101) • Çmimi: 500000,00, Europë 20, Zëri 100,000,00

SHKËLQYRI
I KISHËS KATOLIKE

Prishtinë • Janar 2016 • Viti XXVII • Nr. 1 (101) • Çmimi: 500000,00, Europë 20, Zëri 100,000,00

SHKËLQYRI
I KISHËS KATOLIKE

Prishtinë • Janar 2016 • Viti XXVII • Nr. 1 (101) • Çmimi: 500000,00, Europë 20, Zëri 100,000,00

SHKËLQYRI
I KISHËS KATOLIKE

Prishtinë • Janar 2016 • Viti XXVII • Nr. 1 (101) • Çmimi: 500000,00, Europë 20, Zëri 100,000,00

SHKËLQYRI
I KISHËS KATOLIKE

Prishtinë • Janar 2016 • Viti XXVII • Nr. 1 (101) • Çmimi: 500000,00, Europë 20, Zëri 100,000,00